

albISLAM

REVISTË E PËRMUAJSHME FETARE KULTURORE SHKENCORE



SHFRYTËZOJI PUSHIMET

DIJA QË VRET • SHËRIMI ME RUKJE
SI PO MË KUPTON BURRI IM • KURANI DHE JETA
SI E DASHUROVA MBULESËN • SHITJA E GJËRAVE TË NDYRA
SHEMBULL QË DUHET NDJEKUR NGA ÇDO KËNGËTAR

QERSHOR 2008 24 Xhumadel Ula 1429 Viti VI nr.58

MK 50 DEN KV 0.80 €
AL 100 LEK

ISSN 1409-6250



9 771409 625002

Pyetje dhe përgjigje, faqe

EDITORIAL



albiSLAM

Faqe 5

Raport: Për kë do të votojnë myslimanët e Amerikës?



Faqe 8

Shkencëtarët dhe mendimtarët irakian në shënjestër



Faqe 12

SHEMBULL QË DUHET NDJEKUR NGA ÇDO KËNGËTAR



Faqe 14

MEXHLISI- TUBIMI



Faqe 19

Kurani dhe jeta



Faqe 24

Dallimi midis sprovës dhe ndëshkimit



Faqe 26

Shërimi me anë të Rukjes



Faqe 28

Gjykimi me diçka tjetër përveç asaj që ka zbritur Allahu



Faqe 34

Ndalesa për shitjen e gjërave të ndyra

Faqe 40

Dashuria ndaj Pejgamberit, pagja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të



Faqe 44

S'po më kupton burri im!



Faqe 47

Si të bëhesh nënë më e lumtur (2/2)

Faqe 49

SI E DASHUROVA MBULESËN

Faqe 53

Shfrytëzoji pushimet



Faqe 57

SEXHDEJA, LLOJET DHE RREGULLAT

Faqe 60

Bota e parë përmes dimensionit shpirtëror





Raport: Për kë do të votojnë myslimanët e Amerikës?

Nuha Ebu KERAMAT

Xhezire.net/ Kësaj pyetje ende nuk i kanë dhënë ndonjë përgjigje të prerë myslimanët e Amerikës. Edhe pse disa anojnë nga ndonjëri kandidat, madje ka të atillë që e ndihmojnë aktivisht ndonjërin, prapë se prapë gjysma e myslimanëve të atjeshëm nuk kanë vendosur se për kë do të votojnë.

Rezultatet e një ankete të bërë nga Qendra Islamike e Uashingtonit për të Drejtat e Njeriut me qëllim përmirësimin e raporteve islame-amerikane (CAIR), të publikuara më

31.01.2008 bëri të ditur se më shumë se gjysma e votuesve myslimanë akoma janë në fazën e vlerësimit të kandidatëve dhe nuk kanë vendosur asgjë se për kë do të votojnë.

Kjo anketë bën të ditur se 80% e votuesve myslimanë marrin pjesë rregullisht në votimet presidenciale amerikane dhe se po ata kanë vendosur që edhe këtë vit do të marrin pjesë në votimet e radhës. Aty mësuam se shumica e myslimanëve amerikanë nuk janë anëtarë të asnjë partie, por 42%

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta

aktuale

nga ata e konsiderojnë veten demokratë, 17% republikanë dhe 28% nuk i përkasin asnjë partie.

Në këtë anketë bëhet e ditur se çështja më e rëndësishme për myslimanët në zgjedhjet presidenciale të Amerikës është arsimi dhe të drejtat civile, gjë për të cilën ata ndihen të cunguar nga ana e udhëheqjes së Bushit, po ashtu edhe kujdesi shëndetësor, ekonomia dhe raportet e Amerikës me shtetet myslimane.

Megjithëse ekonomia dhe lufta në Irak prish listën e çështjeve më të rëndësishme për elektoratin, qofshin demokratë apo republikanë, për myslimanët çështje më me rëndësi ishte arsimi (89%), pastaj të drejtat civile (86%) dhe ekonomia (85%), gjë e cila është e barabartë me interesimin e myslimanëve amerikanë për çështjen e raporteve midis SHBA-së dhe botës islame.

Ibrahim Hoper, drejtor për marrëdhënie strategjike pranë "CAIR", duke e komentuar këtë anketë thotë: "Secili kandidat duhet ta dijë se myslimanët amerikanë përbëjnë një grup të madh votuesish, që refuzojnë përçmimin dhe mbrojnë diversitetin e tyre, prandaj secili prej tyre duhet ta ketë parasysh këtë gjë".

Kori Sajlor, drejtori i "CAIR" thotë: "Kjo nuk do të ndodhë, nuk ka asnjë shenjë se ndonjëri prej kandidatëve do ta marrë parasysh këtë".

Sajlori sqaron se dyshon që ndonjëri prej kandidatëve do të kthejë fytyrën nga myslimanët amerikanë, përveç

Tek republikanët nuk ka njeri që të shprehi ndonjë interesim për amerikanët myslimanë, ndërsa te demokratët është e qartë se Hilari Klinton nuk gëzon aspak autoritet te myslimanët, sepse shumica e tyre nuk i besojnë asaj.

atëherë kur shoqëria myslimane amerikane do të gëzojë një forcë politike më të madhe.

Ai thekson se sot myslimanët amerikanë përbëjnë një krah të rëndësishëm të votuesve në SHBA, ku po vërejmë një garë të nxehtë midis kandidatëve, siç është Florida – ku jetojnë 6% të myslimanëve nga numri i tyre i përgjithshëm në

Amerikë, Miçigani – 6% po ashtu, Ilinois – 10%, Ohajo – 3% dhe Pensilvania – 4%.

Myslimanët amerikanë përqendrohen në katër shtete të tjera dhe kryesisht: Kalifornia – 19%, Nju Jorku – 13%, Teksasi – 9%, Virxhinia – 7% dhe Merilandi 5%.

Qysh para disa vitesh midis organizatave islamike dhe atyre çifute ka pasur një debat të gjerë rreth numrit të myslimanëve në Amerikë, sepse në Amerikë është e ndaluar të pyesësh për fenë e tjetrit. Organizatat islamike thonë se numri i myslimanëve amerikanë arrin në 10 milionë, numër i cili është dyfish më i madh, se numri i çifutëve me 5.6 milion, e që është i llogaritur me saktësi.

Llogaritjet reale shënojnë se numri i myslimanëve në Amerikë është nga 4 – 7 milionë njerëz, nga gjithsej 300 milionë banorë. Nga ky numër i myslimanëve, sipas revistës "Time" dhe Institutit arabo-amerikan, 25-30% janë myslimanë zezakë dhe 25-30% myslimanë arabë.

Amid Safi, profesor i shkencave islame në universitetin e Karolinës

Veriore thotë: “Përballë neverisë së kandidatëve, që të flasin me elektoratin mysliman gjendet edhe mosbesimi për ata politikanë nga ana e shoqërisë islame amerikane”. Po ashtu shton se: “Të gjithë kandidatët flasin për myslimanët, por shumë pak prej tyre flasin me myslimanët, e nëse flasin me ta do të binden se të gjitha çështjet që janë të rëndësishme për amerikanët, si arsimi, mjedisi, ekonomia dhe shëndetësia janë të rëndësishme po aq edhe për amerikanët e tjerë, që janë myslimanë.

Safiu gjithashtu thotë: “Tek republikanët nuk ka njeri që të shprehi ndonjë interesim për amerikanët myslimanë, ndërsa te demokratët është e qartë se Hilari Clinton nuk gëzon aspak autoritet te myslimanët, sepse shumica e tyre nuk i besojnë asaj, ngaqë ajo me gjithë fuqinë e saj i armiqësoi myslimanët me qëndrimet e saj në përkrahje të Izraelit. Ndërsa Obama gëzon një përkrahje më të madhe prej shumë amerikanëve myslimanë.

Prandaj Samir Shehate, profesor i politikave arabe pranë universitetit Xhorxhtoun shpreh bindjen, se votuesit myslimanë kësaj radhe do të drejtohen drejt kutive të votimit në numër të madh dhe me entuziazëm, si asnjëherë më parë në histori.

Ai shton se një përqindje e madhe e amerikanëve myslimanë do ta votojnë senatorin demokrat Obama dhe kjo ka për të ndodhur për disa shkaqe:

Shumë prej myslimanëve amerikanë janë me prejardhje afrikane.

Tek Obama shikohet se është më i përmbajtur dhe më i drejtë se Klintoni, kur flet për konfliktin

palestino-izraelit.

Obama ishte kundër luftës në Irak që nga fillimi, gjë që nuk e kishte Klintoni.

Ndërsa dy republikanët Xhon Mekejn dhe Mit Romini gjatë fushatës së tyre në Miçigan u përqendruan në përfitimin e votave të punëtorëve të fabrikave, ndërsa e injoruan shoqërinë kryesore të atij vendi, që ka në përbërjen e saj 500,000 amerikanë me prejardhje arabe, sipas institutit amerikan – arab, prandaj kjo gjë ndikoi që ata të ndjehen atje si të huaj dhe të dështuar.

Besam Murad, kryeredaktor i revistës “Michigan Arab Times” thotë se nuk i kujtohet që ndonjëri prej kandidatëve të dalluar të ketë vizituar një forum amerikan – arab.

Gazeta Kristian Sajns Monitor thotë se Romini shfaqti fytyrën tjetër, kur u pyet se a është e mundshme që në ministrinë e tij për siguri kombëtare të emërojë këshilltarë amerikanë, por me besim Islam dhe ai në këtë rast u përgjigj: “Duke shikuar numrin e amerikanëve myslimanë përballë numrit të përgjithshëm të banorëve, nuk mendoj se do të ishte e arsyeshme të emëroja dikë prej tyre në asi posti. Mirëpo, natyrisht mendoj se është e mundshme një gjë e tillë, që të emëroj ndonjë mysliman në ndonjë post më të ulët”.

Romini, i cili dëshiron që amerikanët të mos e vlerësojnë atë në bazë të besimit dhe i përket grupit Mormon, por dëshiron ta vlerësojnë atë në bazë të cilësive që zotëron, ai tani po i anashkalon myslimanët, vetëm për shkak të besimit, duke pretenduar se qenkan pakicë për të merituar një post

më të lartë ku gatuhet politika.

Ndërsa Mekejni u shpreh për Detroit Fri Pres, se ballafaqimi me ekstremizmin është shkaku kryesor që e shtyu në garën presidenciale. Gjatë një debati në Karolinën Jugore, Mekejni theksoi: “Nuk dua të kem asnjë bashkëpunim me Al-Kaedën, e tëra që duan nga bashkëpunimi është perçja”.

Biznesmeni i madh 60 vjeçar Viktor Galib Bixh, i cili mori pjesë fuqishëm në fushatën e Bushit në vitin 2000, habitet me ndjenjat armiqësore ndaj myslimanëve të kandidatëve, gjë e cila sipas tij është vetëm fanatizëm i verbër. Sipas Detroit Fri Pres, Bixhi thotë: “Të gjithë ata janë duke punuar që Islamin dhe myslimanët t’i paraqesin si djaj, të gjithë e dimë se kemi problem me terrorizmin, prandaj duhet të përqendrohemi si të bashkëveprojmë me të konkretisht, në vend të përqendrimit ndaj një besimi apo populli”.

Amerikanët myslimanë i kanë kundërshtuar prononcimet e Mekejnës dhe thonë se është një gjë normale lufta ndaj Al-Kaedës, mirëpo çuditën pse Mekejni shprehet me nënkuptime të poshttra dhe mashtruese në llogari të veshjes së grave myslimane.

Dija që vret

Shkencëtarët dhe mendimtarët irakian në shënjestër

ALI KASH

Nëse dëshiron ta dëmtosh një vend merrja dijetarët me lloj-lloj joshjesh, mirëpo nëse dëshiron ta shkatërrosh atë vend, atëherë vriti dijetarët e atij vendi. Me këtë vepër e largon nga ky vend elementin bazë të zhvillimit, përparimit dhe rilindjes. Letrarët janë ndërtuesit e kulturës, kurse shkencëtarët ndërtuesit e civilizimit. Vlera e çdo vendi në aspektin shkencor vlerësohet me numrin e shkencëtarëve. Për këtë shkak sistemi i kaluar ka shpenzuar miliarda dollarë për të krijuar një infrastrukturë të shëndoshë për zhvillimin shkencor dhe teknologjik, duke i ofruar kështu mundësi mendjeve dhe

njerëzve të shkathët për të shtuar dijet dhe njohuritë e tyre, duke i dërguar ata në vende të ndryshme të botës. Edhe pse këto kuadro kanë përjetuar presione prej vendeve të ndryshme, që të mos kthehen në vendin e tyre, mirëpo efekti i tyre ka qenë i kufizuar dhe nuk ka arritur të krijojë ndonjë ndikim të madh.

Me kthimin e kësaj elite shkencore në Irak, ata arritën suksese në përparimin e madh shkencor në të gjitha sferat e zhvillimit. Për shkak të kërcënimit që i kanosej Irakut nga shumë palë, ata synuan zhvillimin e infrastrukturës së armatosur për t'u ballafaquar me ta dhe për të krijuar një baraspeshë në rajon. Të gjithë e dimë se sovraniteti dhe pavarësia mund të sigurohet vetëm me ekzistencën e forcave të armatosura të afta, në sasi dhe cilësi. Ky zhvillim i madh teknologjik ishte një pikë befasuese për shumë shtete të rajonit dhe të huaja dhe në të njëjtën kohë

burim rreziku për shumë shtete perëndimore dhe disa shtete arabe, të cilët në vend që ta konsiderojnë Irakun burim kryesor të fuqisë së arabëve, ata u sollën me ta me një fëlliqësi të paparë. Ata ua dhanë sekretet ushtarake armiqve të Irakut dhe i stimuluan, drejtpërsëdrejti apo indirekt ata për ta goditur Irakun.

Dëshmitë e gjeneral Tomi Franks, të cilat i ka përmendur në librin "Ushtari im në Irak" hedh dritë mbi këto të vërteta dhe pas këtyre dëshmime shpalosen nënshtrimi i disa liderëve arab ndaj planeve çifute dhe komplotit kundër Irakut.

Franksit, në takimin me mbretin Abdullah të dytë të Jordanisë me datë 23/01/2003 i është thënë:

"Besoj se irakianët fshehin armë kimike dhe biologjike dhe këto informata janë të marra prej burimeve të sigurta të inteligjencës". Vazhdon



Franksi sqarimet e veta, ku tregon se e ka falënderuar Mbretnin për këto informata të çmueshme dhe i ka dërguar një telegram urgjent ministrit Ramsfeld!

Në të njëjtin libër tregohet se Husni Mubareku, kryetari i Egjiptit e ka këshilluar duke i thënë:

“Gjeneral, duhet të jesh shumë i kujdesshëm. Ne kemi folur me Sadam Husenin, ai zotëron armatim për shkatërrim masiv dhe armë biologjike, me të cilat do t’ju sulmojë“.

Franksi i mbyll këto dëshmi duke treguar se për një orë ky mesazh i ka shkruar Ramsfeldit!

Me këtë tradhti janë sjellë shtetet arabe kundër vëllait të tyre, Irakut!

Nga ana tjetër kryetari i Sirisë, Beshar Esed e plasi edhe një të vërtetë rreth vizitës së ish ministrit për punë të jashtme, Kolin Paelit, që bëri në Damask pak javë pas rënies së Sadam Huseinit, i cili krejt mburrje me atë që bënë në Irak, e befasoi Beshar Esedin, duke mos kërkuar largimin e rezistencës palestineze nga Siria, por solli një gjë që kurrë nuk është përmendur, e ajo është se Siria duhet të mos pranojë shkencëtarët dhe mendimtarët irakian në trevat e veta, që të bëhet e qartë më vonë se ato forca i kanë pasur ata në shënjestër dhe se kë kanë arritur e kanë vrarë.

Beshar Esedi shton edhe këtë e thotë:

“U bë e qartë se ata e donin Irakun si

Lideri i partisë “hakmarrja e Zotit”, edhe pse Zoti është larg prej kësaj veprë të shëmtuar, ka treguar se ka vrarë një numër të madh shkencëtarësh dhe profesorësh universitarë dhe normalisht se e tëra kjo ka ndodhur me udhëzim nga Irani, pasi kjo parti është një dorë e zgjatur e Iranit në Irak.

një vend të shkatërruar, edhe për nga trashëgimia, edhe për nga fuqia për të prodhuar mendim”.

Është e ditur se atentatet kundër shkencëtarëve irakian ose arabë, që kanë punuar në Irak kanë filluar me shkencëtarin e atomikës me prejardhje nga Egjipti, Jahja El-Meshed, dhe është zmadhuar e rritur ky problem me okupimin e Irakut, kur filluan spastrimin e shkencëtarëve në mënyrë të planifikuar.

Në realizimin e këtij projekti u bashkuan forcat iraniane, izraelite dhe të tjera, ku secili realizonte agjendën e vet sipas prioriteteve që kishte, sionistët dhe perëndimorët spastronin shkencëtarët, kurse Irani spastronte liderët dhe pilotët, që më vonë të ndërhyjnë në agjendat e njëri-tjetrit, pasi qëllimi i tyre është një, kurse frytet t’i vjelin të dyja palët. Lideri i partisë “hakmarrja e Zotit”, edhe pse Zoti është larg prej kësaj veprë të shëmtuar, ka treguar se ka vrarë një numër të madh shkencëtarësh dhe profesorësh universitarë dhe normalisht se e tëra kjo ka ndodhur me udhëzim nga Irani, pasi kjo parti është një dorë e zgjatur e Iranit në Irak.

Raporti amerikan tregon se shërbimi i inteligjencës izraelite “Mosadi”, së bashku me forcat e tjera kanë spastruar më shumë se 350 shkencëtar të atomikës bërthamore dhe më shumë se 200 profesor universitarë.

Ministria e punëve të jashtme e

SH.B. Amerikës në raportin e vet të publikuar ka konfirmuar, se forcat komando dhe Mosadi punojnë prej një kohe të gjatë në Irak dhe se detyrë e tyre është spastrimi i shkencëtarëve irakian, pasi ata kanë refuzuar bashkëpunimin me forcat e huaja.

Izraeli mendon se prania e shkencëtarëve paraqet vetvetiu një rrezik për sigurinë kombëtare të tij dhe se zgjidhja më e mirë është spastrimi i tyre, kurse forcat e tjera u sigurojnë informata të bollshme për shkencëtarët irakian dhe adresat e tyre ku gjenden.

Forcat okupuese atje i kanë bindur disa shkencëtarë që të bashkëpunojnë me ta dhe t'jua lehtësojnë emigrimin në vendet e tyre, mirëpo shumica dërmuese e shkencëtarëve ka refuzuar bashkëpunimin me ta, një pjesë e tyre ka mbetur brenda Irakut, kurse një pjesë tjetër ka shkuar në vendet fqinjë. Mirëpo ata i përcjellin nëpërmjet ambasadave irakiane jashtë shtetit dhe ato iraniane për të përcaktuar vendndodhjen e tyre. Është e ditur tashmë se ambasadat irakiane janë të nënshtruara ndaj Iranit, sepse shumica e ambasadorëve janë prej partive shiite ose kurde.

Ata për këtë qëllim edhe kanë vjedhur cd-të me CV-të, me të dhënat personale, të profesorëve universitarë nga ministria e arsimit të lartë, që t'i përcjellin ata dhe t'i spastrojnë ata sipas rrezikut të profesioneve shkencore që ushtrojnë, sikurse është fizika, atomika, kimia, biologjia, etj., pastaj edhe përcjellja e atyre që janë jashtë për të përcaktuar rrezikun e profesionit të tyre shkencor.

Të gjitha forcat që marrin pjesë në

këtë komplot mundohen të paraqesin vrasjen e tyre si akte të Al-Kaidës dhe grupacioneve të tjera xhihadore, pra, bëhet fjalë për një teatër të fabrikuar dhe e zbuluar, prandaj edhe nuk ka nevojë për shumë mund për të njohur palët e vërteta, që qëndrojnë pas këtyre atentateve!

Secili prej nesh mund të parashtojë një pyetje të thjeshtë: kush përfiton nga këto spastrime?! Përgjigjen do ta gjejë sa çel e mbyll sytë! Gjithashtu edhe likuidimi i liderëve ushtarakë dhe pilotëve e ndriçon edhe më tepër këtë çështje.

S'ka dyshim se ruajtja e këtij thesari me shkencëtarë dhe profesorë universitarë është përgjegjësi e secilit irakian dhe jo të nxjerrim pa faj shtetin nga ruajtja e tyre, sepse ata shumë thjeshtë janë njëri prej të dy palëve, ose të futura direkt në këto atentate, ose të paaftë për t'i mbrojtur ata, sepse nuk kanë kontroll mbi atë që ndodh në terren, pra, secila gjë është më e keqe se tjetra.

Kërkojmë prej shkencëtarëve tanë, Allahu i ruajt, që të jenë syçelë, të ruhen në shtëpitë e tyre, në punët e tyre, ose gjatë shkuarjes dhe kthimit nga puna, kontrollimi i veturave para hipjes në to, mos-hapja e dritareve sidomos në vende ku ka shumë njerëz, mos-dalja në vende publike etj. Këto gjëra janë të ditura për të gjithë.

Allahun e lusim që t'i ruajë të gjithë irakianët nga kurthet e thurura, t'i dështojë komplotet për shkatërrimin e këtij vendi dhe t'i sjellë një përfundim të lavdishëm këtij vendi.

Përshtati: Bekir Halimi

SHEMBULL QË DUHET NDJEKUR NGA ÇDO KËNGËTAR

(me rastin e albumit të ri nga Adem Ramadani)

Shkruan: Lulzim SUSURI

I Dërguari i Allahut, paqja dhe lëvdatat e Zotit qofshin mbi të, thotë: “Vërtetë zemrat e njerëzve janë mes dy gishtave të Allahut, Ai i rrotullon ato si të dojë.”

Disa njerëz e kanë provuar shfrenimin, qoftë pak apo shumë, kanë provuar shumë gjëra me të cilat Allahu nuk është i kënaqur, të gjitha këto gjëra i kanë vepruar duke menduar se ashtu duhet shijuar jeta apo duke menduar se ajo është kënaqësia. Por pas atyre gjërave kanë parë se të gjitha ato janë kotësi dhe vetëm se e zhysin më tepër shpirtin në fundërrinat e humbjes dhe të vuajtjeve të tij. Këto vuajtje kanë qenë shkak i fillimit të hulumtimit të së vërtetës dhe kënaqësisë së saj, një e vërtetë e cila shëron dhe gëzon çdo shpirt të vuajtur dhe të mjeruar. Më pas qoftë herët apo vonë këta njerëz e gjetën të vërtetën, e gjetën kënaqësinë që u mungonte dhe të cilën e kërkonin kah mot. Nga të gjitha shtresat e njerëzve pati nga këso persona,

që e kërkuan të vërtetën, disa ishin të pasur, ca të tjerë të varfër, personalitete, të famshëm, artistë, këngëtarë etj., të gjithë këta Allahu me mëshirën e Tij i udhëzoi tek e vërteta. Pranimi i Islamit, apo fillimi i praktikimit të rregullave të tij nga ana e tyre u bë burim krenarie dhe kënaqësie për myslimanët, të cilët gjithmonë mirëpresin diçka të tillë. Ata pasi u udhëzuan, me ndihmën e Allahut, nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por menduan ta ndihmonin dhe të kontribuonin për Islamin, secili nga drejtimi i tij, me aq sa kishte mundësi. Vepruan kështu, që me këto punë të mira që po bënin të ishin shkak që Allahu me mëshirën e Tij t’ua falte gabimet e bëra shumë herët para udhëzimit. Ky ishte inspirimi i tyre dhe shkak për ndryshim nga e keqja në të mirë, ku edhe pastaj u vërejtën rezultatet e punës së tyre nga e cila patën dobi si ata vetë; po ashtu edhe besimtarët.

Nëse dikur ishin shembull dhe frymëzim për keq, më vonë u bënë shembull për mirë, me ta lavdëroreshin injorantët pastaj filluan të lavdërohen besimtarët.

Njëri ndër këta njerëz është edhe ish-këngëtari, Adem Ramadani, i cili ka qenë ndër këngëtarët më të njohur të kohës së tij. Por deshi Allahu dhe e udhëzoi me mëshirën e Tij. E pranoi të vërtetën, jo pse pat dështuar në karrierën e vet si këngëtar, por për arsye se Allahu ia deshi të mirën, sepse ishte prej atyre që filluan ta kërkonin të vërtetën.

Ky udhëzim u mirëprit nga besimtarët e me të shpresojmë të jenë gëzuar edhe banorët e qiellit, por pati nga ata që u mërzitën me këtë gjë, nuk u erdhi aspak mirë, bile edhe filluan të flisnin aty-këtu kundër tij. Disa edhe shpifën gjëra interesante, ku ndër ato që më kujtohet është shpifja e disa personave se Adem Ramadani ka vdekur. Shpesh ndodhte që vëllezërit në qytetin tonë më pyesnin se, a është e vërtetë që Adem Ramadani ka vdekur? Unë ua ktheja se Ademi nuk ka vdekur, përkundrazi ai prej ditës së udhëzimit ka lindur me të vërtetë, kurse shpifësit e tij në të vërtetë janë të vdekur, edhe pse ecin në mesin e të gjallëve.

Udhëzimi i tij është shembulli më i mirë që duhet ndjekur nga çdo këngëtar, ish-koleg i tij, si dhe çdo njeri tjetër. Ky gjest me të vërtetë është për t'u përmendur, por ajo që unë desha ta theksoj më tepër është çështja se Adem Ramadani përveç kthesës në jetën e tij, ai bëri një kthesë akoma më të madhe edhe në profesionin e tij, ku nga këngëtar kaloi në këndues të ilahive, i cili me to arriti një sukses të dukshëm. Ai përveç kësaj me ilahitë e tij arriti të bashkojë mes ndjenjave fetare dhe ato kombëtare, ku

këto të fundit nuk janë aspak në kundërshtim me mësimet fetare. Këtë më qartë e vërejmë sidomos në produksionin e tij të fundit, ku shumë këngë të kënduara me dhjetëra e qindra vite me radhë nëpër odat tona, që kanë qenë vendmësimi i shqiptarëve, ai arriti t'i këndojë në një stil krejt të ri, i cili realizohet ndoshta për herë të parë në këto treva. Ai arriti që këngët patriotike në të cilat flitet për trimëritë dhe bëmat e myslimanëve shqiptarë t'i këndoj në stilin e ilahive të pashoqëruara me muzikë. Kjo vepër për të cilën duhet falënderuar ky njeri, i cili me ilahitë e tij pushtoi veshët e zemrat e shumë njerëzve, të cilët më parë dëgjonin muzikë. Në fund lus Zotin e Madh, që me mëshirën e Tij ta udhëzojë njerëzimin tek e vërteta dhe t'i largojë nga devijimi. Gjithashtu i lus të gjithë këngëtarët, që ta ndjekin rrugën e Adem Ramadanit, si në udhëzim ashtu edhe në këtë stil të ri të këndimit të ilahive, ku përmes tyre arriti të bashkojë mes komponentes fetare dhe tjetrës kombëtare, të cilat tek populli ynë kanë qenë gjithmonë të bashkuara! Le të mbetet ky njeri, ai që do të shënojë një kthesë pozitive në traditën e çdo këngëtar, i cili shpresojmë të pasohet nga të tjerët, *e "kush mbjell një traditë të mirë do të shpërblehet për punën e bërë, ashtu siç do të shpërblehet për punën e çdo pasuesi të tij, duke mos u munguar këtyre të fundit nga shpërblimi i tyre asgjë"*, thotë i Dërguari i Allahut, pagja dhe lëvdatat e Zotit qofshin mbi të.

Lus Allahun Fuqiplotë, që ta udhëzojë në fe, ta forcojë, ta ruajë nga mendjemadhësia e devijimi dhe mos t'ia marrë shpirtin ndryshe veçse si mysliman.

MEXHLISI- TUBIMI

etika dhe norma

Ihsan b. Muhamed UTEJBI

1- Shpeshtimi i përmendjes së Allahut.

Abdullah b. Omeri përcjell se i Dërguari i Allahut, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Çdo popull që tubohet në një vend, e pastaj ngrihet prej tij duke mos e përmendur Allahun, kjo do të jetë hidhërim për ta Ditën e Gjykimit.”* (shënon Ahmedi).

Prej përmendjes së Allahut janë edhe këto veprime:

-Leximi i Kuranit. Ebu Hurejre përcjell se i Dërguari i Allahut, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Kush hap një rrugë që përmes saj të kërkojë dituri, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në xhenet. Kur mbliidhen në një shtëpi të Zotit (xhami) për të lexuar aty librin e Zotit (Kuranin) dhe për ta mësuar atë, mbi njerëzit zbret qetësia, i mbulon mëshira, i mbulojnë melekët me krahët e tyre dhe i përmend Zoti tek krijesat që janë afër Tij (melekët). Prandaj kujt nuk i bëjnë dobi (Ditën e Gjykimit) punët e tij, nuk i bën dobi as prejardhja e vet.”* (Muslimi).

-Istigfari, kërkimi faljes për mëkatet.

Ibën Omeri përcjell se ia numëronte fjalët e të Dërguarit, paqja dhe



lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, përmes të cilave ai kërkonte falje, numri i tyre vetëm në një tubim arrinte në njëqind.” (Tirmidhiu dhe Ibën Maxhe).

-Lartësimi, falënderimi, kërkitimi i xhenetit dhe kërkitimi i mbrojtjes nga Zjarri.

Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, përcjell se i Dërguari i Zotit, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Zoti ka melekë që enden rrugëve duke kërkuar njerëz që e përmendin Atë. Nëse gjejnë njerëz të tillë, atëherë thërrasin njëri-tjetrin: vraponi tek ajo që kërkon. Pasi afrohen i mbulojnë këta njerëz me krahët e tyre njëri mbi tjetrin deri në qiell. Allahu, edhe pse e di se çfarë është duke ndodhur i pyet këta melekë: “Çfarë thonë robërit e Mi?” “Të lartësojnë, të madhërojnë dhe të falënderojnë”, - ia kthejnë melekët. Allahu thotë: “A më kanë parë, që veprojnë kështu?” “Jo, o Zot, nuk të kanë parë”. “Po çfarë do të bënin sikur të më shihnin?” “Po të të shihnin do të adhuronin, lartësonin dhe madhëronin edhe më tepër”. Allahu prapë i pyet: “Çfarë luten ata?” “Kërkojnë nga Ti xhenetin”. “Po a e kanë parë atë?” “Jo, o Zot. “Sikur ta shihnin si do të veprojnë?” “Sikur ta shihnin do të kujdeseshin edhe më shumë për të, do ta kërkonin më tepër dhe do t’u shtohesh dashuria për të”. Allahu pyet: “Nga çfarë kërkojnë mbrojtje?” “Kërkojnë mbrojtje nga Zjarri”. “A e kanë parë atë?” “Jo, o Zot”, ia kthejnë melekët. “Po çfarë do të bënin sikur ta shihnin atë?” “Do të iknin sa më larg prej tij dhe do të frikësoheshin edhe më tepër”. Atëherë Allahu thotë: “Dëshmojini se ua kam falur mëkatet”. Një melek thotë: “O Zot, mes tyre ndodhet një njeri që ka

“Tri gjëra mos u pakësofshin kurrë, por gjithmonë u shtofshin: Paraja e fituar me hallall që shpenzohet në hallall, vëllai në fe tek i cili gjen prehje dhe njeriu besnik, të cilit kur i beson pasuri të rehatohet zemra.”

ardhur për nevoja personale”. Allahu me këtë rast thotë: “(faleni edhe atë) sepse ata (ata me të cilët rri ai) janë popull që nuk ua sheh sherrin”. (Buhariu dhe Muslimi).

2- Zgjedhja e shokut të mirë për të ndenjur me të:

Ebu Musa Eshariu, Allahu qoftë i kënaqur me të, përcjell se i Dërguari, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Shembulli i ndenjes me njeriun e mirë dhe me të keqin është si shembulli i atij që mbart misk dhe atij që është farkatar. Mbartësi i miskut ose të dhuron pak nga ai, ose blen nga ai, ose së paku, merr aromë të këndshme prej tij. Ndërsa farkatari, ose t’i djeg rrobat me gacë, ose merr erë të keqe nga ai.” (Buhariu dhe Muslimi).

Ebu Seidi përcjell se i Dërguari i Zotit, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Çdo udhëheqës ka dy lloj këshilltarësh pas vetes. Ata që e urdhërojnë tek e mira dhe e nxisin për të, dhe këshilltarë që e urdhërojnë tek e keqja, dhe e nxitin për të.” (Buhariu).

Alkame tregon se si kishte shkuar në Sham. Pasi ishte futur në xhami dhe kishte falur dy rekate namaz, dhe ishte lutur duke thënë: “O Zot, ma mundëso të rri me një njeri, që është me të vërtetë i devotshëm”. Ai vazhdon tregimin e tij duke thënë: eca pak derisa u afrova tek disa njerëz, ku edhe u ula aty. Me këtë rast u ul afër meje një i moshuar për të cilin pasi pyeta të tjerët se kush ishte, më thanë se ai ish Ebu Derdai (një nga shokët e

të Dërguarit të Zotit, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të), të cilit i thashë: Iu luta Allahut të më ofrojë një shok të mirë e ja, Ai të solli ty. Ai më pyeti: Nga je? I thashë: nga Kufa. Prapë m'u drejtua: A nuk është midis jush Abdullah b. Mesudi,

bartësi i nallaneve të Pejgamberit, ai që hynte kur dëshironte në shtëpinë e tij dhe bartësi i enës së tij? A nuk është mes jush Amari, ai për të cilin na tregoi Allahu përmes të Dërguarit të Tij, se e ka mbrojtur nga shejtani. A nuk është mes jush ai (Hudhejfi), të cilit i Dërguari i mësoi fshehtësitë (që Allahu i pat treguar)? Pastaj më pyeti se si Abdullah b. Mesudi e lexon suren **“Uel-lejli idha lagsha”**. Pasi ia lexova, më tha: për Zotin, këtë sure i Dërguari, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, ma pat mësuar drejtpërdrejtë nga goja e tij në gojën time. (Buhariu 3742).

Ebu Hurejre, radijAllahu anhu përcjell të ketë thënë Profeti, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të: *“Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj secili të ketë kujdes me kë shoqërohet.”* (Ebu Davudi 4833 dhe Tirmidhiu 2378).

Muadh b. Xhebeli thotë: “Mos u ul me njerëzit nga të cilët nuk përfiton dituri.”

Ibën Mesudi thotë: “Tri gjëra e mbushin zemrën e njeriut me besim: shoqërimi me dijetarë, leximi i Kuranit dhe agjërimi.”

Abdurrahman b. Ebi Lejla thotë: “Mos u ul me armikun tënd, sepse ai t'i përgjon dhe t'i mbledh gabimet, si

E ja çfarë ndodh me ne sot, vdekja nuk na erdhi veçse pasi i drejtuam majat e shtizave tona në fytyrat e vëllezërve tanë.”

dhe polemizon me ty kur ti thua të vërtetën”

Ibën Axhlani thotë: “Tri gjëra mos u pakësofshin kurrë, por gjithmonë u shtofshin: Paraja e fituar me hallall që shpenzohet në hallall, vëllai në fe tek i cili gjen prehje dhe njeriu besnik, të cilit kur i

beson pasuri të rehatohet zemra.”

3-Ndalohet ngritja e njeriut nga vendi ku është ulur:

Ibën Omeri na përcjell se i Dërguari, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, *e ka ndaluar të ngrihet njeriu nga vendi i tij, që të ulet aty një person tjetër. Por ai thotë: Zgjeroheni vendin për të tjerët, duke u ngushtuar mes vetes.* Për këtë shkak Ibën Omeri e urrente të ngrihej njeriu nga vendi i tij që të ulej ai në të. (Buhariu dhe Muslimi). Ibën Omeri vepronte ashtu edhe nga modestia, sepse kishte frikë se mos tjetri nuk ngrihej me dëshirë, por nga turpi prej tij.

4- Njeriu, nëse kthehet në vendin e tij, pasi është ngritur, ai ka të drejtë më shumë se çdokush tjetër të ulet aty:

Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, na përcjell se i Dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Nëse ndokush nga ju ngrihet prej vendit të tij e pastaj kthehet në të prapë, atëherë ai ka të drejtë më shumë se çdokush tjetër të ulet në të.”* (Muslimi).

Imam Neveviu thotë: Fjala e të Dërguarit, paqja dhe lëvdatat e Allahut qofshin mbi të, e sapo përmendur tek dijetarët tanë ka kuptimin, se nëse njeriu ulet në xhami apo të ngjashme me të për namaz, ose diçka tjetër e

pastaj largohet nga aty për të marrë abdes, ose për ndonjë nevojë tjetër të shpejtë dhe kthehet shpejt, në këtë rast ky njeri ka të drejtë më shumë se çdokush tjetër të ulet aty në atë kohë të namazit. Nëse ndodh të ulet gjatë kësaj kohe aty dikush tjetër, atëherë është e drejta e këtij të parit ta ngrejë dhe të ulet vetë në të, kurse detyrim i të dytit është ta respektojë kërkesën e tij, duke u bazuar në këtë hadith. Ky është kuptimi i hadithit sipas dijetarëve të medhhebit tonë. Ndërsa disa dijetarë të tjerë thonë: ngritja e të dytit nga vendi do të ishte e pëlqyer e jo detyrim. Mendim ky të cilin e përkrah imam Maliku, edhe pse mendimi i parë është më i saktë. Dijetarët thonë se nuk ka dallim, nëse njeriu ngrihet nga vendi duke mos lënë kurrfarë shenje në atë vend apo duke lënë ndonjë shenjë, siç është sexhadeja dhe të ngjashme. Por kjo e drejtë i takon atij vetëm për namazin paraprak e jo për të gjithë namazet. Allahu e di më së miri!

5- Mos pengimi i bashkë-ulësve në asnjë prej formave: Xhabiri tregon se një njeri ecte në xhami me shtizë në dorë dhe kur e pa i Dërguari, pagja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, i tha: *“Kape shtizën tënde nga maja.”* (Buhariu dhe Muslimi).

Ebu Musa na përcjell se i Dërguari ka thënë: *“Kur ecni në tubim apo rrugë duke bartur me vete shtizë, le ta kapë nga maja e saj, le ta kapë nga maja e saj, le ta kapë nga maja e saj.”* Ebu Musa, duke e komentuar këtë hadith thotë: E ja çfarë ndodh me ne sot, vdekja nuk na erdhi veçse pasi i drejtuam majat e shtizave tona në fytyrat e vëllezërve tanë.”

6- T'i përshëndesë me selam të pranishmit kur vjen dhe largohet nga mexhlisi: Ebu Hurejre përcjell se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Kur dikush nga ju vjen në tubim, le t'i përshëndesë të pranishmit me selam e pastaj, nëse do le të ulet e pastaj le të ngrihet. Pasi të largohet, le t'i përshëndesë prapë të pranishmit, sepse selami i parë nuk është më i vlefshëm se i dyti.”* (Ebu Davudi 5208, Tirmidhiu 2706).

7- Të ulet aty ku përfundon mexhlisi: Xhabir b. Abdullahu tregon se në kohën e Profetit, kur shkonin në mexhlis uleshin në fund të tij. (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu).

8- Mos t'i ndajë dy vetë, që janë ulur bashkë, duke u ulur mes tyre: Abdullah b. Amri na përcjell se Profeti, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Nuk i lejohet askujt t'i ndajë dy persona duke u ulur mes tyre, veçse me lejen e tyre.”* (Ebu Davudi 4844 dhe Tirmidhiu 2752).

9- Të thotë lutjen e mexhlisit në fund të tij: Ebu Hurejre na përcjell se Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush rri në tubim ku shpeshtohen gabimet, pastaj para se të ngrihet thotë lutjen: Subhaneke Allahume ue bi hamdike esh-hedu en la ilahe il-la ente estagfiruke ue etubu ilejke, i falen gabimet e atij tubimi.”* (Tirmidhiu 3433).

10- Mos të ulet ca në hije e ca në diell: Ebu Burejde përcjell se babai i tij e ka dëgjuar të Dërguarin, pagja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, duke e ndaluar uljen në një vend ku gjysma e trupit është në hije e gjysma tjetër në diell. (Ibën Maxhe).

11- Nëse kotet në tubim, le të largohet që aty: Ibën Omeri tregon se

e ka dëgjuar Profetin, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, duke thënë: “Nëse dikush nga ju kotet në xhami ditën e xhuma le të largohet nga vend-ulja e tij duke u ulur në një vend tjetër.” (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu).

12- Mos të përgjojë bisedat e të tjerëve që janë ulur afër tij: Ibën Abasi përcjell se i Dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, thotë: “Kush pretendon se ka parë ëndërr duke mos qenë e vërtetë një gjë e tillë do të detyrohet që (ditën e gjykimit) t’i lidhë dy kokrra drith, çka nuk mund ta bëjë. Kush mundohet të dëgjojë dy vetë, që janë duke biseduar mes vetes e ata nuk kanë dëshirë do t’i hidhet ujë të ngrohtë në veshin e tij. Kush vizaton fotografi (me shpirt) detyrohet t’i japë shpirtin, por s’mundet.” (Buhariu 6635).

13- Mos të ndahen dy vetë për të biseduar, duke u larguar nga i treti pa kërkuar leje prej tij: Abdullah b. Mes’udi Allahu qoftë i kënaqur me të përcjell se i Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Nëse janë tre vetë, mos të ndahen dy prej tyre që të bisedojnë fshehurazi, duke e lënë anash të tretin derisa nuk përzihen me njerëz të tjerë, sepse kjo gjë i hidhëron ata.” (Buhariu 5932, Muslimi 2184).

14- Mosndërhyrja në bisedën e folësit derisa të përfundojë: Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, na përcjell se një ditë i Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ishte duke u mbajtur fjalim shokëve të tij, kur erdhi një nomad dhe i ndërhyri në bisedë duke e pyetur: Kur do të ndodhë Kiameti, por i Dërguari vazhdoi fjalimin e tij, duke mos i dhënë përgjigje. Disa nga të pranishmit kujtuan se Profeti nuk e

dëgjoi, të tjerë thanë se e dëgjoi, por e urreu këtë pyetje prandaj nuk iu përgjigj. Pasi e mbylli fjalimin e tij, ai pyeti: “Ku është pyetësi për ditën e gjykimit?” Pyetësi tha: Këtu, o i Dërguar i Zotit. Profeti i tha: “Kur të humbasë amaneti, prite Kiametin”. Si humbet amaneti, o i Dërguar, pyeti ai. Pejgamberi paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, tha: “Kur t’i besohet detyra një njeriu të papërshtatshëm, prite Kiametin.” (Buhariu).

15- Nuk lejohet të mbështetesh mbi shuplakën e dorës së majtë pas shpine, kur po qëndron ulur: Sherid b. Suvejdi thotë: “Kaloj afër meje i Dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, dhe unë isha ulur në këtë pozicion, pra, i mbështetur me shuplakën e dorës së majtë pas shpine, dhe më tha: “Mos u ul si ata me të cilët Allahu është i hidhëruar.” (Ebu Davudi me sened të mirë).

16- Largimi nga rruga dhe mos-pengimi i njerëzve: Ebu Seidi përcjell se i Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Largohuni nga ulja rrugëve”. Shokët e tij thanë: Ndonjëherë na duhet patjetër të ulemi, sepse kemi nevojë të bisedojmë. Atëherë Profeti, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, u tha: “Nëse duhet patjetër të uleni, atëherë jepini rrugës hakun e saj”. Pyetën: Cili është haku i rrugës, o i Dërguar i Zotit? Tha: Ulja e shikimit, mos pengimi i tjerëve, kthimi i selamit (përhëndetjes), urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.” (Buhariu dhe Muslimi).

Përshtati: Lulzim Susuri

Kurani dhe jeta


19

Prof. Dr. Nasir EL-OMER

Lavdia i takon vetëm Allahut, që e zbriti Kuranin udhëzues për njerëzit me plot fakte nga udhëzimi dhe dallues. E bëri atë rrugë për në Xhenet, shpëtim nga Zjarri, prandaj lum për ata që e kanë bërë Kuranin shok, në varr shoqërues, në Kiamet (Botën tjetër – Ahiret) ndërmjetësues, pastrim nga Zjarri, udhëheqës dhe udhërrëfyes për në Xhenet.

Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi atë që falej duke lexuar Kuran derisa i ënjteshin këmbët nga dashuria ndaj tij (Kur'anit) dhe për atë që e ka zbritur. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin edhe mbi sahabët dhe pasuesit e tij e po ashtu edhe mbi ata që ecin rrugës së tij deri në Ditën e Gjykimit.

Allahu i Madhëruar i ka dhuruar umetit islam një dhunti të madhe



Kurani me të vërtetët është jetë, po të logjikoni njerëzit. Jeta e vërtetë është ajo që ecën në përputhje me metodologjinë e Kuranit; pa metodologjinë e Kuranit, nuk ka më jetë, edhe nëse e shohin njerëzit ndryshe.

Artikuj

1 qershor 2008
25 Rabi' uth - thani

albiSLAM

Kuranin në të cilin ka lajme për ata që ishin para Kuranit dhe për ata që erdhën pas zbritjes së Kuranit; gjykimi për ta është Fjalë Ndarëse, e nuk është për shaka, kush e lë pas shpine Allahu do t'ia "thyejë shpinën", dhe kush kërkon udhëzim në diçka tjetër pos tij, e devijon Allahu. Ai është litari i fortë i Allahut, përmendje e urtë, rrugë e drejtë. Është i atillë që nuk devijon mendja me të, nuk përzihen me të gjuhët, nuk ngopen me të ulematë, nuk është i krijuar, nuk i mbarojnë mrekullitë. Xhinët akoma kur e dëgjojnë thonë: **"...Ne kemi dëgjuar një Kuran që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, prandaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrsesi nuk do t'ia shoqërojmë më askënd Atij."** (Xhin 1, 2). Kush flet sipas tij, thotë të vërtetën, në kohën që vepron me të shpërblehet, dhe kush thërret tek ai, ka udhëzuar tek rruga e drejtë. Ky Libër, që syri nuk e ka parë dhe nuk do të shohë më madhështor, as më të qartë, e as më përmbledhës, më përfshirës, e as më të dobishëm, as më të lehtë, e as më të hapët, na garanton t'u përgjigjet kërkesave të jetës në të gjitha fushat dhe sferat. Jeta nuk është e pavarur nga Kurani, e nuk ka rrugëdalje për një jetesë që meriton të quhet jetesë, përpos se në përputhje me të.

Kurani me të vërtetët është jetë, po të logikonin njerëzit. Jeta e vërtetë është ajo që ecën në përputhje me metodologjinë e Kuranit; pa metodologjinë e Kuranit, nuk ka më jetë, edhe nëse e shohin njerëzit ndryshe. Allahu i Madhëruar thotë: **"Vallë, a është ai që qe i vdekur, kurse Ne e ngjallëm dhe i dhëmë**

dritë, me të cilën ai ecën mes njerëzve, si ai që ka mbetur në errësirë (i humbur) dhe nuk mund të shpëtojë nga ajo? Ja, kështu (si këtij në errësirë) iu duket mirë mohuesve ajo që veprojnë." (Enam 122). Nuk ka jetë pa Kuranin, pra, siç ndodh në rastin e Shpirtit, e a ka jetë pa shpirt?! Allahu i Madhëruar thotë: **"Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kuranin). Ti nuk e ke ditur se çfarë është libri (Kurani), as ç'është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë..."** (Shura, 52).

Jeta pa shpirt nuk është jetë. Atëherë kur t'i merret jetës shpirti, zhduket jeta.

Kurani i përshkruan të vdekur ata që jetojnë pa udhëzimin e tij, edhe pse ata hanë dhe pinë; shkojnë e vijnë. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"E ti nuk mund t'i bësh të dëgjojnë të vdekurit, e as nuk mund ta bësh të shurdhëtin të dëgjojë thirrjen, e sidomos kur ata ta thyejnë shpinën. E as që mund t'i largosh të verbrit nga humbja e tyre (zemrat e verbra), ti nuk mund ta bësh të dëgjojë ndonjë tjetër, vetëm atë që i beson argumentet Tona, e ata janë myslimanë."** (Nemël 80, 81).

Allahu i ka përshkruar këta kundërvajtës të Kuranit me fjalë që nënkuptohen. Allahu i Madhëruar thotë: **"E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e Kiametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: "Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?" Ai (Allahu) thotë: "Ashtu si harrove ti argumentet Tona që t'i**

ofruam, ashtu je ti i harruar sot.” (Ta Ha 124-126).

Si mos të jetë Kurani jetë, kur në të ka gjithçka që kërkojnë njerëzit (krijesat - robërit) për ekzistencën e tyre, atë që i gëzon për të ardhmen e tyre. Aty gjen sistemin e familjes, sistemin shoqëror, sistemin ligjor (të qeverisjes), sistemin e gjykatave. Në të ka ilaç për sëmundjet, këshillë për besim, rregullat (kriteret) e mendimit, korrigjimin e sjelljes.

Në të ka sqarim për hakun e prindit që e ka detyrim i biri dhe për hakun e fëmijës që e ka detyrim prindi, hakun e udhëheqësit ndaj popullit dhe hakun e popullit ndaj udhëheqësit. Aty ka sqarim për hakun e individit ndaj shoqërisë dhe hakun e shoqërisë ndaj individëve. Aty ka sqarime për hakun e gruas ndaj burrit dhe hakun e burrit ndaj gruas. Aty ka sqarime për hakun e vëllait ndaj vëllait të vet dhe hakun e të afërmeve (akrabasë), për hakun e fqinjit dhe mbi të gjitha këto, aty ka sqarim për hakun e robërve ndaj Allahut, pra, a thua jeta mund të jetë diçka tjetër përpos këtyre që u përmendën?!

Allahu ia ka zbritur Librin e Tij Fisnik Pejgamberit të Vet, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, për një qëllim: përmirësimi i dynjasë dhe arritja e lumturisë në Ahiret. Këtë qëllim e ka përfshirë Kurani brenda tij në realizimin e dispozitave, e ligjeve, këshillave dhe mësimëve. Allahu i Madhëruar thotë: *“Falënderimi i takon vetëm Allahut që ia shpalli robët të vet Librin dhe në të nuk lejoi ndonjë kundërrëthënie. (ia shpalli) Të saktë (pa shmangie), për t’ua tërhequr vërejtjen (atyre që nuk besojnë) ndaj një dënimi të rëndë prej*

Tij, e për t’i përgëzuar besimtarët që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë një shpërblim të mrekullueshëm.” (Kehf 1, 2).

Kurtubiu ka thënë: d.m.th., me urtësi të drejtë pa gabime në të, pa çrregullime dhe kontradikta.²³

Allahu ka treguar aty për çdo gjë që kanë nevojë robërit. Allahu i Madhëruar thotë: *“...Ne kemi sqaruar çdo send në mënyrë të hollësishme.”* (Isra 12).

Allahu ua ka zbritur Librat e mëparshëm pejgamberëve të Tij për këtë qëllim; nuk ua ka zbritur për t’i stolitur me ar e as për t’i puthur, por i ka zbritur për t’u dhënë jetë robërve me udhëzimin e tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Ne i dërguam të dërguarit Tanë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të drejtës.”* (Hadid 25). Allahu i Madhëruar po ashtu thotë: *“Ne vazhduam gjurmët e tyre (të pejgamberëve) me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Teveratit që kishin më parë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë.”* (Maide 46). Allahu i Madhëruar po ashtu thotë: *“Njerëzit ishin një popull (të fesë së natyrshme islame) e (kur u përçanë) Allahu iu dërgoi pejgamberët si përgëzues dhe qortues, dhe atyre Ai u zbriti edhe librin me fakte të sakta për të gjykuar në atë që u kundërshtuan.”* (Bekare 213).

Ajete të tjera nga Kurani ka shumë dhe tregojnë se Kurani dhe Librat qiellorë para tij, edhe pse kanë pasur begati në to dhe adhurim me mësimin e Kuranit për umetin e Muhamedit,

paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, dhe në librat e tjera qiellorë për popujt e mëparshëm, kanë qenë nga adhurimet që t'i afrohen më tepër tek Allahu i Madhëruar, mirëpo qëllimi dhe synimi themelor i këtyre librave të famshëm është rregullimi i jetës së njerëzve në përputhje me metodologjinë e Allahut dhe përmirësimin e tokës me zakonet e qiellit. Mushrikët në kohën e Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, kur e luftonin atë dhe zhvilluan kundër tij gjithë ato beteja të përgjakshme nuk e kuptuan se ajo që u duhet nga Kurani është vetëm lexim, por ata e kuptuan se me thirrjen islame nënkuptohet vetëm ta marrësh Kuranin gjykatës në të gjitha çështjet të veçanta, apo të përgjithshme. Zoti i Urtë i Gjithëdijshtëm që cilësohet me këtotribute të larta dhe quhen Emrat e bukur, është e pamundur që ai ta zbresë Librin e Tij me sqarime të ligjeve me detaje precize nga detajet e jetës e mos të ketë si qëllim përpos që ta lexojnë njerëzit e t'i përsërisin Ajetet e tij.

Allahu e ka dëftuar se qetësimi i krijesave me atë që ka zbritur në Librat qiellorë është qëllimi për të cilin i ka zbritur vetë Librat. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Ai ta zbret ty (Muhamed) librin me argument që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin. Udhërrëfyes për njerëz, zbriti edhe Furkanin (dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtër)." (Ali Imran 3, 4).**

Pasi Allahu e zbriti Ademin, paqja e Zotit qoftë mbi të, në Tokë, ia sqaroi

atij se udhëzimin e Zotit të Madhëruar do t'ia zbresë atij dhe pasardhësve të tij, po ashtu e sqaroi edhe për pasojat e atyre që e ndjekin dhe pasojat e atyre që e kundërshtojnë. Allahu i Madhëruar thotë: **"Ai (Allahu) u tha: "Zbritni prej aty që të gjithë, do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Nëse u vjen nga Unë udhëzim (libër e pejgamber) kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në dynja) e as nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër)". E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kiametit do ta ringjall të verbër."** (Ta Ha 123, 124).

Allahu na ka treguar se të mëparshmit, po të plotësonin atë që u qe zbritur nga Zoti i tyre do ishin të lumtur në dynja dhe në Ahiret. Allahu i Madhëruar thotë: **"Dhe, sikur ta zbatonin Tevratin, Inxhilin dhe Kuranin, që u zbritën nga Zoti i tyre, ata do të kishin furnizim me bollëk nga qielli dhe toka. Është një grup i drejtë (i matur) prej tyre, por është e keqe ajo që punojnë shumica prej tyre."** (Maide 66). Allahu i Madhëruar po ashtu thotë: **"Sikur t'i kishim detyruar ata: mbytni vetveten tuaj, atë (detyrim) nuk do ta zbatonin, me përjashtim të një pakice prej tyre. Po sikur të zbatonin atë që këshilloheshin do të ishte më mirë për ta dhe do t'i përforconte më shumë. Dhe atëherë do t'u jepnim atyre nga ana Jonë shpërblim të madh. Dhe do t'i udhëzonim në rrugë të drejtë."** (Nisa 66-68).

Jeta e vërtetë përqendrohet në

vënien në jetë të asaj që u ka zbritur Allahu i Madhëruar pejgamberëve të Tij dhe në zbatimin e atyre që i ka detyruar Allahu nga largimin nga ato që i ka ndaluar nga Haramet.

Selefët (gjeneratat e para të umetit) dhe jeta Kuranore

Selefus-salih e kanë lexuar Kuranin me gjithë thellësinë e shpirtit. Ibën Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: Kur ta dëgjosh thënien e Allahut të Madhëruar “*ja ej-juhel-lehdhine amenu*” (o ju që keni besuar), përqendroje dëgjimin, se mund të jetë ndonjë hair që të urdhëron ta bësh, ose ndonjë sherr nga i cili të ndalon. Pasi ka zbritur ajeti i hixhabit, gratë e sahabëve nxituan t’i përmbahen atij urdhri. Pasi tha Allahu i Madhëruar: “*O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedh armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?*” (Maide 90, 91). Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: ndaluam, ndaluam. Pasi ka zbritur ky ajët, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: Allahu i Madhëruar e ka ndaluar verën, e këdo të arrijë ky ajët, e tek ai ka diçka nga ajo (vera), mos ta pijë e as mos të shesë. Myslimanët i

derdhën fuqitë me verë dhe një kohë rrugëve të Medinës erëzonin nga vera e derdhur, aq shumë verë u derdh.

Pra, shiko, sa shpejt u nënshtruan dhe ku ishte jeta e tyre. Po kështu kemi rastin me ndërrimin e Kibles prej Bejtul-Makdisit drejt Qabesë. Si e pranuan urdhrin me bindje. Ndërrimi i Kibles ishte një sprovë për ta, sprovë për të ditur kush është i gjallë dhe kush është i vdekur. Allahu i madhëruar thotë: “*E kiblen nga e cila ti u drejtove nuk e bëmë për tjetër, vetëm se për të provuar atë që shkon pas të dërguarit, nga ai që kthehet prapa.*” (Bekare 143). Ata e kaluan këtë sprovë. Në hadithin e Berait, i cili thotë: Në fillim, kur pati ardhur (pejgamberi) në Medinë, shkoi te gjyshërit (apo ka thënë te dajallarët) nga Ensarët dhe u fal në drejtim të Bejtul-Makdisit gjashtëmbëdhjetë muaj, apo shtatëmbëdhjetë muaj, por i pëlqente që kibla e tij të jetë nga Qabeja. Namazin e parë që fali Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të (në drejtim të Qabesë), ishte namazi i ikindisë dhe me të u fal një grup njerëzish, pastaj dolën nga ata që u falën me të dhe kaluan pranë atyre që ishin në xhami e ata kishin qenë në ruku dhe iu thanë: Betohe në emër të Allahut, se jam falur me të Dërguarin e Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, në drejtim të Mekës, e ata u kthyen siç ishin në drejtim të Shtëpisë së Shenjtë të Qabesë.

Përktheu: Ali SHABANI

Dallimi midis sprovës dhe ndëshkimit

Muhamed Salih EL MUNAXHID

Falënderuar qoftë Allahu. Paqja dhe bekimet qofshin për të Dërguarin e Tij, Muhamedin, mëshirën e mbarë njerëzimit, dhe mbi të gjithë ata që e pasuan dhe do ta pasojnë atë deri në Ditën e Fundit të kësaj bote.

Ndëshkimet janë pasojë e asaj që njerëzit veprojnë (bëjnë keq). Sprovat janë teste dhe prova, të cilat Zoti i dërgon për të provuar njerëzit. Njerëzit mund të sprovohen me gjëra të mira ose të këqija.

Lidhur me ndëshkimin Allahu thotë në Kuran: *“Çfarëdo e mire që të vjen është nga Allahu, e nëse të vjen ndonjë e keqe është nga vetë ti”*. (Sure Nisa: 79).

Lidhur me shprehjen *“është nga vetë ti”* Katade thotë: *“dënimi është për ty, o bir i Adem, për shkak të mëkatit tënd.”* Ebu Salihu thotë: *“e nëse të vjen ndonjë e keqe është nga vetë ti”* nënkupton *“për shkak të mëkatit tënd, dhe Unë (Allahu) jam Ai që e urdhëroj atë për ty”*. (Tefsiri i Ibën Kethirit). Allahu gjithashtu thotë: *“Çfarëdo e keqe që mund t’ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai ju fal.”* (Sure Shura: 30).

Ibën Kethiri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: *“Çfarëdo fatkeqësie t’ju ndodh, o njerëz është për shkak të veprave të këqija që ju tashmë i keni bërë, dhe ‘Ai fal shumë’ iu referohet veprave të këqija- Ai nuk ju dënon juve për ato vepra, por Ai i fal ato.”* *“E sikur Allahu t’i kapte njerëzit sipas veprave (të këqija) të tyre, nuk do të linte mbi faqen e dheut asnjë gjallesë, por Ai i afatizon deri në çastin e caktuar, e kur të vijë afati i tyre, s’ka dyshim se Allahu i ka parasysh robërit e vet”*. (Sure Fatir: 45).

Lidhur me sprovat, i Dërguari i Zotit, paqja qoftë për të, thotë: *“Kur Allahu e do një popull, Ai e sprovon atë, dhe kushdo që ka durim, le të ketë durim, dhe kushdo që shqetësohet, le të shqetësohet.”* (Imam Ahmedi, Sahih el-Xhami: 1706). I Dërguari i Allahut gjithashtu thotë: *“Niveli (madhësia, sasia) i shpërblimit do të jetë në përputhje me lartësinë (madhësinë) e sprovës. Kur Allahu e do një popull, Ai e sprovon atë, dhe kushdo që është i kënaqur, le të jetë i kënaqur, dhe kushdo që zemërohet, le të zemërohet.”* (Tirmidhiu, 2320, Sahih el Xhami: 2210).

Përvijimet vijuese tregojnë shumë qartë dallimin midis sprovës dhe ndëshkimit: Nëse fatkeqësia (sprova)



rezulton nga kryerja e një akti si bindje ndaj Allahut, p.sh., të qenit i plagosur në rrugë të Allahut, humbja e parave kur të migrosh për hir të Allahut, ose humbja e një pune për shkak se je mysliman, ose për shkak të përparimit tënd në zbatimin e ndonjë detyrimi në islam, atëherë kjo është **sprovë**. Gjithsecili që i duron këto sprova me durim do të shpërblehet, por nëse reagon me hidhërim (zemërim), atëherë do të fitojë Zemërimin e Allahut. Nëse fatkeqësia rezulton nga mëkate të tilla, si sëmundjet e transmetuara seksuale, ose sëmundjet e shkaktuara nga pirja e alkoolit dhe përdorimi i drogës etj., atëherë ky është ai lloj **ndëshkimi** që vjen në këtë botë (në krahasim me të qenit i afatizuar gjer në Ahiret). Nëse fatkeqësia nuk është e lidhur, as me veprën e mirë, as me mëkatin - të tilla

si lloje të tjera sëmundjesh, humbja e fëmijës, dështimi në biznes - atëherë ajo varet nga situata (gjendja) e njeriut.

Nëse ai është i mirë dhe i devotshëm, kjo është një sprovë dhe nëse ai është mëkatar, kjo është ndëshkim për të.

Fatkeqësia mund të jetë një ndëshkim për t'i pastruar mëkatet, ose mund të jetë një sprovë duke pasur si qëllim ngritjen e statusit (gjendjen) të njeriut dhe ngritjen e sevapeve të tij - kjo mund të jetë e përcaktuar nëse një njeri është i bindur ose jo. Një njeri nuk duhet ta lavdërojë veten, madje vlen e kundërta, ai duhet ta kritikojë veten për të metat e tij e të përpiqet të arrijë përsosmërinë. Njeriu do të përfitojë nga fatkeqësitë që e godasin në çdo rast, nëse ai bën durim dhe shpreson shpërblim tek Allahu.

***Përshtati nga anglishtja:
Fitim NUHIU***

Shërimi me anë të Rukjes

Hani b. Abdullah EL-KHISR

Kohëve të fundit në shoqërinë tonë është përhapur shërimi me anë të Rukjes, një gjë që nuk është e ndaluar. Kjo dukuri ka sjellë edhe disa gabime, ku disa rrenacakë dhe magjistarë po e mbulojnë mashtrimin u tyre me petkun e Rukjes, e për këtë shkak në këtë artikull desha të sqaroj disa kritere që duhet të kemi parasysh.

E para: Rukja nuk ka të bëjë me njerëz të veçantë. Ajo nuk është lëmi që lyp ndonjë studim special, as nuk lyp ndonjë prirje të madhe. Është një lloj lutjeje për çdo njeri që i lutet Allahut dhe i di rregullat e lutjes.

E dyta: Rukja ka kriteret e veta, të cilat i kanë përmendur dijetarët(1), e ato janë:

1- Të jenë shprehje të qarta dhe të kuptueshme;

2- Në to, të mos ketë shirk e as të kërkosh ndihmë nga dikush tjetër pos

Allahut.

Auf b. Malik tregon: I Dërguari i Allahut, pagja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “*Nuk ka problem nëse bën Rukje, kur nuk bëhet shirk në të.*”(2)

3- Të mos bëhet Rukje në vende apo gjendje të ndaluar, p.sh., në momentin kur je xhunub, në varreza etj.

4- Gjatë Rukjes të mos përdoren sharje, mallkime, fjalë fyese etj.

5- Të mos jetë i bindur se Rukja ka ndikim vetvetiu.

E treta: Ndodh nganjëherë që gjatë Rukjes të bëhen disa gabime, që vërtetojnë se ai që po bën rukje është magjistar, ose së paku bidatçi, si p.sh.:

1- **Rukje me anë të zmadhuesve të zërit**, me telefon ose u bën Rukje një grupi njerëzish përnjëherë. Kjo fetva është e dhënë nga Komisioni i Përhershëm për Fetva, i cili thotë se Rukja të bëhet aty për



aty, duke e argumentuar se kjo është në kundërshtim me atë që ka vepruar i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, dhe shokët e tij. Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, thotë: Kush shpik diçka të re në fenë tonë ajo është e refuzuar.(3).

2- Prekja e gruas

Nuk lejohet prekja e trupit të gruas, të cilën e ke të lejuar të martohesh me të.

Komisioni i Përhershëm për Fetva thotë: Nuk lejohet që të preket gruaja gjatë Rukjes, por vetëm duhet t'i lexohet nga larg.(4)

3- **Nuk duhet të përvetësohet rukja**, sepse Allahu subhanehu ve teala e ka bërë Rukjen shkak për t'u shëruar, pa marrë parasysh se a e di se çfarë sëmundje ka, sihr (magji), mësysh apo diçka tjetër.

4- **Të vetmuarit me gruan e huaj** gjatë Rukjes. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: Mos të veçohet kush me gruan e huaj, pos me mahrem (me atë që e ka të ndaluar martesën).(5)

5- **Rrahja e pacientit apo lidhja e tij**. Disa nga ata që bëjnë Rukje i rrahin, i lidhin apo i ngufasin pacientët me pretekstin, se ajo mënyrë i largon xhinët. Dijetari i njohur Abdulaziz b. Bazi thotë: Ai që bën Rukje duhet të largohet nga kjo mënyrë, sepse mund të dëmtohet pacienti(6), ai vetëm duhet t'i lexojë Kuran dhe të bëjë lutje për të. Kjo gjë është e përcjell nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Sikur të ketë qenë e dobishme kjo gjë, atë do ta sqaronte i Dërguari i Allahut subhanehu ve teala.

6- **Të kërkosh nga pacienti që të**

Ai që bën Rukje duhet të ketë sjellje të mirë dhe të mos ketë tek ai shenja mëkati dhe gjëra të urryera.

therë dash, gjel apo të ngjashme me shpresën se kjo gjë do ta ndihmojë për t'u shëruar. Në një nga fetvatë e Komisionit të Përhershëm për Fetva thuhet: Të shkosh për Rukje tek ai që lexon ajete Kurani dhe urdhëron therjen

e dashit, kaut e të ngjashme është bidat dhe ngrënie e pasurisë së dikujt në mënyrë të padrejtë.(7)

7- **T'i kërkosh emrin e nënës pacientit apo ndonjë pjesë nga rrobat e tij**.

Komisioni i Përhershëm për Fetva thotë: Është e ndaluar që të shkohet për Rukje tek ai që pretendon se i di të fshehtat, as nuk lejohet që t'i dërgohet diçka nga rrobat, as që t'i besohet se çfarë thotë ai.(8)

8- **Të urdhërohet pacienti që të mbajë ndonjë kafshë**, apo në shtëpinë e tij të vihet ndonjë kafshë, qoftë qen apo ujë. Komisioni i Përhershëm thotë se kjo gjë është një lloj besëtytnie.(9).

9- Përdorimi i hajmalive

Ato janë disa letra në të cilat shkruhen disa ajete nga Kurani apo diçka tjetër, kjo pa dyshim është e ndaluar.

Komisioni i Përhershëm për Fetva thotë: Të mbaj me vete dikush hajmali që ka të shkruar diçka nga Kurani është haram. Por të ketë të shkruar diçka tjetër është edhe më keq. Kategorizimi i të keqes bëhet sipas qëllimit të personit i cili e bën atë. Ajo mund të jetë, ose shirk i vogël, ose bidat dhe mëkat. Pa marrë parasysh, ky veprim assesi nuk është i lejuar(10).

10- **Të shkruarit e ndonjë sure** apo disa ajete nga Kurani në letër, hamer apo diçka tjetër dhe larja e tyre me ujë. Në një nga fetvatë e Komisionit të Përhershëm për Fetva thuhet: Shkrimi i sures dhe

ajeteve të Kuranit në letër dhe larja e tyre me ujë dhe shafan, e pastaj të pihet prej saj me shpresë se ajo do të sjellë begati, dituri, pasuri, shëndet etj., kjo nuk është përcjell nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, që ka vepruar për vete e as për dikë tjetër. Ai nuk ka mësuar dikë të veprojë kështu, e as shokët e tij nuk kanë vepruar kështu. Sikur të ketë qenë kjo gjë e mirë do t'i jepte dikujt leje që të vepronte kështu(11).

E Katërta: Ai që bën Rukje duhet që ta lexojë Kuranin mirë, t'i dijë duatë që janë të transmetuara, të cilat i kanë përmendur dijetarët në librat e tyre, si p.sh., Imam Neveviu në librin “El Edhkar”, Ibën Tejmije në librin “Fjala e bukur”, Ibën Kajimi në librin “El-vablu sajjib min kelami tajib” etj.

Po ashtu ai që bën Rukje duhet të ketë sjellje të mirë dhe të mos ketë tek ai shenja mëkati dhe gjëra të urryera. Pra, këto janë disa gjëra, të cilat duhen t'i kenë parasysh ata që kanë marrë përsipër këtë detyrë

- 1- Fethul Bari 10/166 ,
- 2- Sahihul Muslim-kitabus-selam
- 3- Sahihul Buhari, Komisioni për fetva (fetvaja nr. 2361)
- 4- Komisioni për fetva (fetvaja nr. 2361)
- 5- Buhariu dhe Muslimi
- 6- Mexheletu da've nr. 1543
- 7- Fetvaja e Komisionit të Përhershëm nr. 6733
- 8- Fetvaja e Komisionit të Përhershëm nr. 9807
- 9- Fetvaja e Komisionit të Përhershëm nr. 9496
- 10- Fetvaja e Komisionit të Përhershëm nr. 2775
- 11- Fetvaja e Komisionit të Përhershëm nr. 1257.


Përktheu: Enver Azizi

Gjykimi me diçka tjetër përveç asaj që ka zbritur Allahu

përgatiti: Omer ZAIMI

Shejh Muhamed b. Salih el-Uthejmin në librin e tij “El-Kaul el-mufid ala Kitabit-teuhid”, libër në të cilin shpjegon “Librin e Teuhidit” të Muhamed . Abdulvehabit, në temën “Kush i respekton dijetarët dhe udhëheqësit në bërjen haram atë që Allahu e ka bërë hallall, apo në bërjen hallall atë që Allahu e ka bërë haram i ka marrë për zota”, në mes tjerash thotë:

Dobi: Allahu i Lartësuar ata që gjykojnë me diçka tjetër përveç asaj që ka zbritur Ai i ka emërtuar me tre cilësi:



1- Allahu i Lartësuar thotë: ***“E kush nuk gjykon me atë që e ka zbritur Allahu, ata janë qafira.”*** (Maide: 44).

2- Dhe thotë: ***“E kush nuk gjykon me atë që e ka zbritur Allahu, ata janë zullumqarë.”*** (Maide: 45).

3- Si dhe thotë: ***“E kush nuk gjykon me atë që e ka zbritur Allahu, ata janë fasika.”*** (Maide: 47).

Në mes dijetarëve ka mospajtim në lidhje me domethënien e këtyre ajeteve:

Disa kanë thënë: Këto cilësi janë për një emërtim të njëjtë, sepse qafiri është zullumqar, siç thotë Allahu i Lartësuar: ***“Qafirat, mu ata janë zullumqarë.”*** (Bekare: 254). Po ashtu ai është fasik, siç thotë i Lartësuari: ***“Ndërsa ata që kanë bërë fisk, vendbanimi i tyre është***

xhehenemi.” (Sexhde: 20). D.m.th.: që kanë bërë kufër.

Ndërsa disa të tjerë kanë thënë: Këto cilësi janë për të cilësuar njerëz të ndryshëm dhe dallon gjykimi në bazë të ndryshimit të gjendjeve, e ky është mendimi më i saktë.

Prandaj ai që nuk gjykon me atë që e ka zbritur Allahu është qafir në tre gjendjet, në vijim:

1- **Nëse beson se lejohet të gjykohet** me diçka tjetër përveç asaj që ka zbritur Allahu. Argument për këtë është fjala e Allahut: ***“A gjykim të xhahilijetit kërkojnë?”*** (Maide: 50). Prandaj çdo gjë që e kundërshton gjykimin dhe ligjin e Allahut është gjykim xhahilijeti (injurance), me argument Ixhmain (konsensusin) e prerë, se nuk lejohet të gjykohet me diçka tjetër pos asaj që ka zbritur Allahu. Prandaj ai që beson se lejohet të gjykohet me ligj tjetër pos ligjit të Allahut kundërshton kështu ixhmain e prerë të myslimanëve, prandaj ai është kafir murted (i dalë nga feja), po ashtu sikurse edhe ai që beson se lejohet zinaja dhe rakia, apo si ai që beson se ndalohej buka dhe qumështi.

2- **Nëse beson se ligji i dikujt tjetër** pos Allahut është njësoj me ligjin e Allahut.

3- **Nëse beson se ligji i dikujt tjetër** pos Allahut është më i mirë se ligji i Allahut. Argument për këtë është fjala e Allahut: ***“E kush është ligjvënës më i mirë se Allahu, për një popull që beson me bindje.”*** (Maide: 50). Ky ajet tregon se ligji i Allahut është ligji më i mirë. Po ashtu argument është fjala e Allahut: ***“E a nuk është Allahu ligjvënësi më i mirë?”*** (Tin: 8). Pra, pasi Allahu është ligjvënësi më i mirë dhe

ligji i Tij është ligji më i mirë, atëherë, kush pretendon se ligji i dikujt tjetër është njësoj me ligjin e Allahut apo më i mirë, ai është qafir, sepse ai përgënjeshtrohet Kuranin.

Ndërsa është **zullumqar**: Nëse beson se ligji i Allahut është ligji më i mirë dhe më i dobishëm për robërit dhe vendet, dhe se është detyrim veprimi sipas tij, mirëpo urrejtja dhe hakmarrja ndaj të gjykuarit (popullit) e çojnë që të gjykojë në kundërshtim me ligjin e Allahut, në këtë rast ai është zullumqarë.

Dhe është **fasik (mëkatar i madh)**: Nëse gjykon me diçka tjetër përveç asaj që ka zbritur Allahu, për shkak të epshit të tij, duke besuar se ligji i Allahut është ligji i vërtetë, mirëpo gjykon ndryshe për shkak të epshit të tij. D.m.th: Gjykon ashtu për shkak të dashurisë së asaj me të cilën gjykon, jo për shkak të urrejtjes ndaj ligjit të Allahut e as për ta dëmtuar dikë. Si për shembull: Të gjykojë në dobi të dikujt, për shkak të ryshfetit që i kanë dhënë, apo për shkak se e ka të afërt apo shok, apo për shkak se kërkon prej tij kryerjen e ndonjë nevojë, etj., duke besuar se ligji i Allahut është më i miri dhe se është detyrim pasimi i tij. Në këtë rast ai është fasik, edhe pse në të njëjtën kohë është zullumqar, mirëpo cilësia e fiskut në rastin e tij është më parësore se cilësia e zullumit.

Ndërsa, për sa i përket atij që ka nxjerrë ligje, duke e ditur ligjin e Allahut dhe duke e ditur se këto ligje janë në kundërshtim me ligjin e Allahut, ky e ka zëvendësuar Sheriatin me këto ligje,

"Tekfiri është fetva, madje është prej fetvave më të rrezikshme, prandaj po ashtu siç nuk i lejohet xhematit të rëndomtë të japi fetva, po ashtu nuk i lejohet të bëjë tekfir."

prandaj ky është qafir, sepse e ka zëvendësuar Sheriatin me këto ligje vetëm për shkak se beson se këto ligje janë më të dobishme për robërit dhe vendet, se sa sheriat i Allahut. **Kur themi se është qafir kemi si qëllim: Se kjo vepër të dërgon deri në kufër.**

Mirëpo ka mundësi që ai që i vendos këto ligje të jetë i arsyetuar, si p.sh., të mashtrohet dhe të mendojë, se ato nuk e kundërshtojnë Islamin, apo se janë prej "el-mesalih el-mursele" (prej dobive të përgjithshme), apo mendon se këto gjëra Islami ua ka lënë në dorë njerëzve.

Ka disa prej dijetarëve që janë gabimtarë, të cilët thonë: Marrëdhëniet ndër-njerëzore (el-muamelat) nuk kanë të bëjnë me Sheriatin, por kanë të bëjnë me atë që është më e dobishme për ndonjë kohë të caktuar, dhe nëse koha e kërkon që të vendosin banka me kamatë dhe taksa, kjo gjë nuk është problem. Ky është një gabim në të cilin nuk ka dyshim, nëse kanë bërë ixhtihad, shpresojmë që Allahu t'ua falë, nëse jo, ata janë në një rrezik të madh, prandaj ata duhet të quhen "dijetarë të shtetit" e jo "dijetarë të popullit".

S'ka dyshim se Sheriat ka ardhur për t'i rregulluar adhurimet, që janë ndërmjet njeriut dhe Zotit të tij dhe për t'i rregulluar marrëdhëniet ndër-njerëzore, siç janë: marrëveshjet, kurorat, trashëgimitë etj. Pra, sheriat është i plotë nga të gjitha aspektet, siç thotë i Lartësuari: **"Sot ua përsosa fenë tuaj..."** (Maide: 3). E si ka mundësi të thuhet se marrëdhëniet ndër-njerëzore

nuk kanë lidhje me Sheriatin, ndërsa ajeti më i gjatë në Kuran ka zbritur në lidhje me marrëdhëniet ndër-njerëzore (quhet “ajeti i borxhit”, në suren Bekare sh.p.)?! E sikur mos të kishte Sheriat në çështjet e marrëdhënieve ndër-njerëzore, padyshim se do të shkatërroheshin njerëzit.

Unë nuk them: Të merret çdo fjalë që kanë thënë fukahatë, sepse ata ka mundësi që t’ia qëllojnë dhe ka mundësi që të gabojnë, përkundrazi e kemi detyrim që të marrim çdo fjalë që ka thënë Allahu dhe i Dërguari i Tij. S’ka mundësi që të ndodhë diçka ndërmjet njerëzve, e të mos ekzistojë zgjidhje për këtë problem në Librin e Allahut dhe Sunetin e Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, mirëpo gabimi vjen ose prej mungesës së diturisë dhe kuptimit, ose prej mungesës së analizimit.

Ndërsa në rastin kur njeriut i jepet sukses, që të ketë dituri dhe kuptim, dhe mundohet maksimalisht për të arritur deri te haku, padyshim se do të arrijë deri tek ai, po edhe në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndër-njerëzore (el-muamelat). Allahu i Lartësuar thotë: **“A nuk e analizojnë ata Kuranin?”** (Nisa: 82). Dhe thotë: **“A nuk e analizojnë fjalën?”** (Mu’minun: 67). Si dhe thotë: **“Ky është një libër i begatshëm, të cilin ta kemi zbritur, në mënyrë që ata t’i analizojnë ajetet e tij.”** (Sad: 29). Po ashtu thotë: **“Ta kemi zbritur ty librin që është sqarues për çdo gjë.”** (Nahl: 89). Pra, çdo gjë për të cilën ka nevojë njeriu në fenë apo dynjanë, ai do të gjejë sqarime të mjaftueshme në Kuran dhe të qartë në lidhje me të.

Prandaj kush vendos ligje që e

kundërshtojnë Sheriatin dhe pretendon se ato janë prej dobive të përgjithshme, padyshim se ai është gënjeshtar në pretendimet e tij, sepse dobitë e përgjithshme nëse janë në pajtim me Sheriatin, ato janë hak edhe prej sheriatit, ndërsa nëse janë në kundërshtim me të, nuk janë dobi, e as që kanë mundësi të jenë, për këtë shkak mendimi i saktë është se nuk ka argument në Sheriat, që quhet “el-mesalih el-mursele”, përkundrazi ajo që pajtohet dhe merret në konsideratë nga sheriat, ajo është e dobishme, ndërsa ajo që kundërshtohet dhe nuk merret në konsideratë nga Sheriat, ajo nuk është e dobishme, ndërsa gjërat për të cilat ka heshtur Sheriat, ato janë gjëra që Allahu na i ka falur nga mëshira e tij dhe nuk na ka ngarkuar me to.

Shumë prej njerëzve janë zgjeruar shumë në çështjen e dobive të përgjithshme (el-mesalih el-mursele), duke i futur si të dobishme disa çështje të këqija, prej bidateve dhe të tjera, siç është festa e mevludit, duke pretenduar se në të ka ngritje të ambicieve të njerëzve, sepse ata e kanë harruar Resulullahun, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Kjo është fjalë e kotë, sepse të gjithë muslimanët, në çdo namaz të tyrin dëshmojnë se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Allahut, dhe çojnë salavate mbi të. Prandaj ai që nuk i ngjallet zemra e tij me këtë veprim, në rastin kur ai është duke u falur, përpara Zotit të tij, si ka mundësi që t’i ngjallet zemra në një orë kur këndohen kaside të kota, në të cilat ka teprim dhe që i ka kundërshtuar vetë Resulullahu, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të?! Kjo gjë padyshim është e dëmshme, e assesi nuk është e dobishme.

“El-Mesalih el-mursele” edhe nëse janë vendosur nga disa dijetarë që janë muxhtehidë të mëdhenj, padyshim se qëllimi i tyre me këtë veprim është ndihmesa e fesë së Allahut, mirëpo këto “mesalih – dobi” janë përdorur për gjëra që nuk i kanë pasur si qëllim ata dijetarë dhe është zgjeruar në to. Prandaj ne themi: Këto dobi duhet të vendosen në peshoren e hakut. Nëse Sheriati i pranon, ato pranohen, e nëse jo, themi ashtu siç ka thënë Imam Maliku: “Fjala e çdokujt merret dhe lihet, pos fjalës së pronarit të këtij varri (Resulullahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).” Prandaj ne kemi rregulla të përgjithshme, në bazë të të cilave i vëmë në praktikë çështjet e tjera.

Prandaj duhet ditur se: Është e detyrueshme që njeriu ta ketë frikë Allahun në të gjitha dispozitat dhe nuk duhet të shpejtojë në to, e sidomos për çështjet e tekfirit, në të cilat disa pasues xheloze dhe emocionalë shpejtojnë pa u menduar aspak, duke e ditur se njeriu kur t’i thotë dikujt “qafir”, duke mos qenë ai i tillë, kjo fjalë i kthehet thënësit të saj.

Ndërsa mbi bërjen “tekfir” të dikujt, ndërtohen dispozita të shumta. Pra, nëse i thua dikujt qafir, d.m.th., se gjaku dhe pasuria e tij është hallall, e po ashtu mbi të ndërtohen të gjitha dispozitat e kufirit.

Po ashtu siç nuk lejohet t’i themi qafir një personi të caktuar, derisa të plotësohen për të kushtet e tekfirit dhe të largohen pengesat, po ashtu nuk duhet të jemi frikacakë ndaj bërjes tekfir të atij që Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë bërë tekfir, mirëpo duhet të bëjmë dallim ndërmjet personit të caktuar dhe dispozitës së përgjithshme. Prandaj për ta bërë tekfir një person të caktuar duhet

të plotësohen dy gjëra:

E para: Vërtetimi se kjo vepër në të cilën ka rënë ai, është kufër.

E dyta: Plotësimi i kushteve të tekfirit. Prej kushteve më të rëndësishme është dituria e tij se kjo vepër është kufër, e nëse është i paditur, nuk bën kufër, prandaj dijetarët e kanë përmendur, se prej kushteve për ta dënuar ndonjë person është që ai ta ketë ditur se ajo vepër është e ndaluar. Nëse kjo është në një dënim, e jo në shpalljen e tij qafir, atëherë në rastin e tekfirit të tij duhet të jemi edhe më të kujdesshëm.

Allahu i Lartësuar thotë: *“Të dërguar, përgëzues e vërejtje-tërheqës, në mënyrë që njerëzit mos të kenë argument para Allahut pas dërgimit të pejgamberëve.”* (Nisa: 165).

Po ashtu thotë: *“E ne nuk dënojmë dikë, derisa të dërgojmë pejgamber.”* (Isra: 15).

Si dhe thotë: *“Allahu nuk është i tillë që ta devijojë një popull pasi ta ketë udhëzuar, derisa t’ua bëjë të qartë gjërat nga të cilat duhet të ruhen.”* (Teube: 115).

Prandaj duhet patjetër që të plotësohen kushtet dhe të largohen pengesat. Për këtë shkak nëse një njeri vepron diçka që është kufër, duke qenë i detyruar ta bëjë këtë vepër, nuk bën kufër. Allahu thotë: *“Kush bën kufër ndaj Allahut, pas besimit të tij, pos atij që është i detyruar, ndërsa zemra e tij është e mbushur me iman.”* (Nahl: 106). Ndërsa ai njeriu që e gjeti devenë e tij pak para se të vdes tha: *“O Allahu im! Ti je rob i im, ndërsa unë jam zoti yt. Gaboi nga gëzimi i madh që kishte.”* (shënon Buhariu). Mirëpo ai nuk u dënua, sepse atë fjalë e tha gabimisht nga gëzimi i madh.

Këtu përfundon fjala e Shejhut, Allahu e mëshiroftë.

Në mënyrë që të plotësohet dobia, unë do të përmend shkurtimisht një mesele: A lejohet që xhemati (xhemati i rëndomtë: çdokush që nuk është talebe i pjekur dhe që nuk është dijetar) të bëjë tekfir dikë?

Padyshim që kjo është një mesele shumë e rëndësishme, që ka nevojë të bëhet një studim më i gjerë në lidhje me të, sepse jemi sprovuar në këtë kohë me njerëz, që as gjuhën arabe nuk e dinë, mirëpo kanë guxim që me të madhe të bëjnë tekfir. E ajo që është edhe më musibet jemi sprovuar me talebe të tillë, që u thonë këtyre njerëzve: Nuk ka problem, nëse i di kushtet dhe pengesat e tekfirit mund të bësh tekfir sa të duash.

Unë nuk kam hasur te këta njerëz, se kanë ndonjë argument më të madh, se sa një fetva të Ali Hudejrit, i cili e thotë të njëjtën gjë me dy-tre fjalë, duke mos përmendur asnjë argument.

Unë këtu vetëm po transmetoj atë që kam dëgjuar me veshët e mi nga dijetarë më të mëdhenj se i sipërpërmenduri, në lidhje me këtë çështje.

E kam dëgjuar Shejh Muhamed Muhtar Shenkitin në fillim të këtij viti, në një nga derset e tij, që i mban natën e xhumasë pas akshamit në Xhaminë e Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, pasi u pyet për këto mesele duke thënë:

“Dije se akuzimi i dikujt me tebdîe (t’i thuash bidatxhi) apo tekfir (t’i thuash qafir) është më i madh se akuza që i bëhet atij në nderin e vet. Dije se po ashtu sikurse bidati që të dërgon në kufër, po ashtu tebdîu me të pa drejtë të dërgon në tekfir. Ne themi se tekfiri është çështje që u takon gjykatësve të

muslimanëve, e assesi nuk i takon xhematit të rëndomtë, sepse nëse ata bëjnë tekfir krijohet çrregullim i madh në tokë dhe lejohet gjaku dhe pasuria e muslimanëve me të pa drejtë.”

Dhe e kam dëgjuar Shejh Adnan Arurin duke thënë: “Tekfiri është fetva, madje është prej fetvave më të rrezikshme, prandaj po ashtu siç nuk i lejohet xhematit të rëndomtë të japi fetva, po ashtu nuk i lejohet të bëjë tekfir.”

Nga kjo që përmendëm mund të përfundojmë se: Tekfiri nuk i lejohet xhematit të thjeshtë me argumentet se:

1- **Tekfiri është ixhtihad**, ndërsa ixhtihadi i takon muxhtehidit, gradë të cilën xhemati i rëndomtë s’ka gjasa ta arrijë.

2- **Tekfiri është fetva**, madje prej më të rrezikshmeve, ndërsa xhemati i rëndomtë nuk guxon të jep fetva.

3- **Xhemati i thjeshtë nuk i di rregullat e përgjithshme të sheriatit** dhe metodat e argumentimit, prandaj edhe nëse i mësojnë kushtet dhe pengesat përmendësh, prapë se prapë gjykimi i tyre do të jetë i gabuar.

4- **Nga kushtet thelbësore**, që i kanë përmendur dijetarët për të dhënë fetva dikush është njohja e gjuhës arabe. Xhemati i rëndomtë nuk e njeh gjuhën arabe, e mos të flasim për kushtet e tjera shumë të rënda që pasojnë më tej. E si ka mundësi atëherë që ata të japin fetva apo të bëjnë tekfir?!

5- Nëse **xhemati i rëndomtë bën tekfir** do të gabojë në shumicën e rasteve, e kjo do të thotë se do ta lejojnë gjakun dhe pasurinë e muslimanëve, e kjo do të dërgojë deri në fesad, armiqësi dhe vrasje.

Nëse do dëshironim, do të

përmendnim edhe shumë argumente të tjera, mirëpo këto mjaftojnë për atë që dëshiron me singëritet ta dijë të vërtetën në këtë mesele.

Për të qenë edhe më të saktë themi: Po ashtu nëse dikush e pyet xhematin e rëndomtë: a është detyrim namazi. Ai përgjigjet: PO. Po ashtu edhe nëse dikush thotë: Unë jam i krishterë, jehudi, laik, apo e shan Allahun dhe Pejgamberin e Tij, po ashtu në këtë rast i lejohet xhematit të rëndomtë të vërejë, se ky person nuk qenka musliman.

Qëllimi im ishte për atë gjykim tek i cili mund të arrihet vetëm nëpërmjet ixhtihadit, siç është rasti për lënësin e namazit, apo për atë që voton, apo për çështje të tjera në të cilat ka mospajtim ndërmjet dijetarëve fillimisht, dhe së dyti për të arritur deri te gjykimi në to ka nevojë për ixhtihad.

Në fund e lus Allahun që ta bëjë këtë temë të dobishme për vëllezërit e mi muslimanë, sepse jam i bindur që shumë prej tyre janë kureshtarë dhe nuk kanë gjetur përgjigje të plotë në lidhje me të, edhe pse i njëjti rast ka ndodhur me mua, para disa viteve.

Ndalesa për shitjen e gjërave të ndyra

Përgatiti: Omer BERISHA

Prej gjërave që dihen mirëfilli e që janë theksuar edhe në Librat e mëhershëm dhe pejgamberët e mëparshëm është edhe ajo që në këtë Fe, gjërat e mira janë hallall, ndërsa ato të ndyrat janë haram. Ky ligj është i përgjithshëm në kapitullin e hajes, pijes, veshjes, traditave dhe në të gjithë kapitujt e tjerë. Ky është një rregull madhështor, me të cilin mirëmbahet çdo e mirë, braktiset çdo ndyrësi dhe është peshore për të vlerësuar çdo risi, që paraqitet në çdo kohë si gjë e re dhe në atë mënyrë që të bëjmë krahasimin e drejtë.

Me këtë rregull vërehet përkryerja e këtij Sheriati, gjë e cila garanton edhe qëndrueshmërinë e kësaj Feje dhe vërteton se

ajo do të jetë e përhershme.

Argumentet nga Kurani dhe Suneti janë të shumta, por ne do të përqendrohemi në hadithin e mëposhtëm, të cilin e ka shënuar Buhariu (nr. 2236), Muslimi (nr. 1581) dhe të tjerë. Vërtetësia e hadithit as që diskutohet përderisa gjendet i shënuar në ato libra të vërtetë, prandaj edhe do ta sjellim këtë hadith dhe do të mundohemi të nxjerrim mësim të dobishme prej tij:

Xhabir b. Abdullahu, Allahu qoftë i kënaqur me të, rrëfen se në vitin e Çlirimit e kishte dëgjuar të Dërguarin, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, duke thënë: *“Allahu dhe i Dërguari e kanë ndaluar shitjen e alkoolit, cofëtisë, dërrit dhe putave”. Dikush pyeti: Si është puna me dhjamin e cofëtisë? Sepse me të lyhen anijet, ngjyen lëkurat e regjura dhe përdoret për kandil? Jo, ajo është haram – u përgjigj i Dërguari paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, dhe pas kësaj shtoi:*

Allahu i vraftë çifutët, kur Allahu ua ndaloi dhjamin (e cofëtisë), ata e shkrinin, pastaj e shisnin dhe e hanin kundërvlerën e tij”.

Domethënia e përgjithshme:

Me “Viti i Çlirimit” kuptohet viti kur u çlirua Meka, gjë e cila ndodhi në muajin Ramazan të vitit 8 H. Sheriati i pastër Islam erdhi për të sjellë çdo gjë të mirë për njerëzimin dhe për tërhequr vërejtjen nga çdo gjë që e dëmton mendjen, trupin dhe fenë. Prandaj gjërat e mira i bëri hallall – të cilat janë shumë ndërmjet gjithë atyre që ka krijuar Allahu, ndërsa gjërat e këqija dhe të ndyra i bëri haram.

Prej gjërave të ndyra janë edhe këto katër gjëra që u përmendën në hadith, ku secila prej tyre shkakton dëme të llojeve të veçanta.

Alkooli – ose çdo gjë që deh – është nëna e të këqijave, ajo i shkakton njeriut humbjen e mirësisë së mendjes, gjë me të cilën Allahu e nderoi njeriun dhe e

dalloi prej krijesave të tjera. Në gjendje të dehur njeriu bën çfarëdo lloj harami që ka mundësi, shkakton probleme dhe armiqësi me të gjithë që takohet dhe normalisht ajo gjendje pengon nga hairi dhe përmendja e Allahut.

Pas kësaj përmendi cofëtinën, e cila në të shumtën e rasteve ngordh pas helmimit nga mikrobet e ndryshme, nga sëmundjet ose është furur dhe gjaku ka mbetur brenda në mish dhe mishi është prishur. Ngrënia e kësaj cofëtime është shumë e dëmshme për trupin dhe shkatërruese për shëndetin. Krahas gjithë këtyre gjërave, cofëtina është e ndyrë, e fëlliqur, e kalbur dhe e papastër, saqë nuk i afrohet asnjë njeri normal.

Më pas përmendi edhe kafshën më të keqe dhe më të shëmtuar, derrin, i cili në vetvete përmban sëmundje dhe mikrobe nga më të ndryshmet, të cilat edhe me zjarr nuk digjen e nuk vriten. Dëmi i derrit është i madh dhe i llojlojshëm, krahas ndyrësisë dhe papastërtisë që ka.

Në fund përmendi edhe atë me të cilin shkaktohet dëmi dhe çrregullimi më i madh, putat, idhujt, të cilët e humbin njerëzimin nga e drejta. Me këto idhuj është kundërshtuar Allahu dhe është bërë shirk ndaj Tij, duke i adhuruar ato puta, ndërsa dihet se të gjitha krijesat i kanë hak Allahut, që vetëm atë ta adhurojnë. Të gjithë peygamberët që kanë ardhur, librat që janë zbritur dhe dijetarët që kanë luftuar kanë pasur një qëllim: idhujt të luftohen, njerëzit të zgjohen dhe i gjithë ibadeti t'i drejtohet vetëm Allahut.

Sa e sa njerëz kanë devijuar nga kjo rrugë, sa popuj kanë shtrembëruar teuhidin dhe sa njerëz do të hyjnë në

Zjarr për këtë haram të madh që po bëhet vazhdimisht kundër Allahut. Këto haramë të ndyra janë adresa e të gjitha dëmeve dhe të këqijave, të cilat sulmojnë mendjen, trupin dhe fenë e njeriut.

Këto pra, janë vetëm shembuj për të na mësuar se duhet të largohemi nga çdo punë e ndyrë, me qëllim që të mbrojmë mendjen, trupin dhe dinin tonë. Nëse largohemi nga ato, veçse i kemi mbrojtur, Allahu na ndihmoftë.

Dispozitat e mësuar nga hadithi:

1. E drejta për t'i thënë një gjëje haram apo hallall i takon vetëm Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Atë që Allahu dhe i Dërguari paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, e quajnë haram – ajo është haram, dhe atë që Allahu dhe i Dërguari, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, e quajnë hallall – ajo është hallall. Prandaj kushdo që mundohet të nxisë të kundërtën, pavarësisht se kush është, fjala e tij nuk merret parasysht, kur bie ndesh me lejimin apo ndalimin që ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të.

2. Shitja e alkoolit është haram, për këtë pajtohen të gjithë dijetarët, e njëjta gjë vlen edhe për pirjen dhe mbajtjen e tij në shtëpi apo në lokalin tënd. Më shumë se një dijetar e ka theksuar se rreth kësaj çështje ka ixhma (konsensus) në mesin e dijetarëve. Nga ata janë Ibnul Mundhiri dhe Neveviu.

Enesi ka thënë: "I Dërguari, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, *i ka mallkuar dhjetë njerëz që kanë të bëjnë me alkoolin: prodhuesin, atë për të cilin prodhohet, pirësin, bartësin, atë për të cilin bartet, atë që e shërben, atë që e shet, atë që*

ha kundërvlerën e alkoolit, atë që blen dhe atë për të cilin blihet”. (Sahih Tirmidhi 1295).

Urtësia e ndalimit është e qartë: shkakton urrejtje dhe armiqësi dhe më e rëndësishmja: njeriun e mençur e bën të çmendur.

3. Është haram shitja e cofëtinës, me gjithë çka ka – dhe për këtë Ibnul Mundhiri thotë se ka ixhma ndërmjet dijetarëve.

Cofëtina është haram të hahet, por është haram edhe të shitet, përjashtim ka vetëm cofëtina e peshkut dhe karkaleci, sepse kur e pyetën Resulullahun, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, për detin, ai tha: “Uji i tij është i pastër dhe cofëtina e tij është hallall”, po ashtu ka thënë: “Na janë lejuar dy cofëtina: peshku dhe karkaleci”. Edhe pse zinxhiri i këtij hadithi, sipas mendimit më të saktë ndalet tek Ibën Omeri, kjo llogaritet sikur të ketë zinxhir të plotë, sepse sahabi për gjërat: hallall, haram, ahiret etj., nuk flet asgjë nga vetja.

Nga kjo ndalesë ka përjashtim: leshi i cofëtinës, qimet, puplat – gjëra të cilat nuk mund të quhen cofëtina. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Ndërsa sa i përket lëkurës së cofëtinës, ajo është e ndyrë para se të regjet, por pasi të regjet mirë, kur regjja ia largon ndyrësitat, atëherë ajo lëkurë llogaritet e pastër dhe hallall. Ky është mendimi i shumicës.

4. **Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth përgjigjes së Pejgamberit**, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të: لا، هو حرام - Jo,

Të gjithë pejgamberët që kanë ardhur, librat që janë zbritur dhe dijetarët që kanë luftuar kanë pasur një qëllim: idhujt të luftohen, njerëzit të zgjohen dhe i gjithë ibadeti t’i drejtohet vetëm Allahut.

ajo është haram.

Kush është haram: shitja e dhjavit të cofëtinës apo përdorimi i tij për ato gjëra?

Ata kanë dy mendime:

Mendimi i parë: me Ajo, është për qëllim shitja, d.m.th., nuk lejohet shitja e dhjavit të cofëtinës, që d.t.th., se lejohet përdorimi i dhjavit të cofëtinës, ndërsa ajo që ndalohet

është shitja dhe ngrënia. Këtë mendim e përkrah Ibën Tejmije dhe Ibën Kajimi. Es-Sanani thotë: “Kjo duket se është e vërteta”.

Ibnul Kajimi thotë: “Shejhu jonë ka thënë: Është për qëllim shitja, sepse kur i Dërguari, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, u tregoi se Allahu e ka bërë haram shitjen e cofëtinës, ata thanë: Me dhjavin e cofëtinës mund të kemi këto e këto dobi, prandaj, a na lejohet shitja e dhjavit që të përdoret për këto qëllime? Jo, ajo është haram – u përgjigj ai. Ky është mendimi më i vërtetë, sepse edhe konteksti flet për shitjen, pra, nuk lejohet shitja e dhjavit të cofëtinës”.

Shkak tjetër mund të jetë edhe fakti se përdorimi i dhjavit të cofëtinës në gjëra të tjera përveç ushqimit është dobi e njëmendtë dhe nuk ka asnjë dëm, prandaj themi se lejohet përdorimi i dhjavit të cofëtinës në këso lloj gjëra, por jo edhe shitja e tij.

Ibën Kajimi po ashtu ka përmendur se kufizimet/ ndalesat për përdorimin e gjërave janë më të vogla sesa kufizimet/ ndalesat që janë për shitjen

e gjërave. Më konkretisht ai ka thënë kështu: “Duhet ta dimë se kapitulli i përdorimit të gjërave është më tolerant se kapitulli i shitblerjes. Jo çdo gjë që është e ndaluar të shitet, po ashtu është e ndaluar edhe të përdoret, këto të dyja nuk kanë lidhje mes vete, nuk ka të drejtë askush të llogarisë haram përdorimin e një gjëje, duke u bazuar në faktin se shitja e saj është haram”.

Mendimi i dytë: Është për qëllim përdorimi i dhjavit d.m.th., nuk lejohet përdorimi i dhjavit të cofëtines për asgjë. Neveviu thotë se këtë mendim e përkrah shumica, të cilët thonë se përemri “ajo” ka për qëllim përdorimin, sepse “përdorimi” ishte gjëja e fundit që u përmend. Po ashtu, nëse lejojmë përdorimin e dhjavit të cofëtines kjo do të shkaktojë edhe mbajtjen e tyre nëpër shtëpi dhe pastaj edhe shitjen. Këtë mendim e përkrah edhe Ibën Bazi.

Mendimi i parë duket se është më i vërtetë. Allahu Alem.

5. Shitja e putave është haram.

Ibën Kajimi ka thënë: “Harami i shitjes së putave është haram më i madh dhe në kundërshtim më të madh me Islamin, sesa shitja e cofëtines dhe e derritit”.

Urtësia e kësaj ndalese është e qartë: Ato shkaktojnë shirkun dhe prishin Fenë.

6. Shitja e derritit është haram.

Ibnul Mundhiri thotë: “Dijetarët janë të një mendimi se shitblerja e derritit është haram”.

Ibën Kajimi ka thënë: “Sa i përket shitjes së derritit, me këtë është për qëllim i gjithë ai, pavarësisht a bëhet fjalë për pjesë të brendshme të tij apo të jashtme”. Po ashtu ai ka thënë: “Derri

është haram më i madh, sesa cofëtina”.

E gjitha kjo, për shkak të dëmeve të shumta që ka, për shkak të sëmundjeve që shkakton dhe po ashtu ka ndikim të fëlliqur në nderin dhe xhelozinë e njeriut për nderin e vet.

7. Është e lejuar t'i mallkojmë çifutët, për shkak të tradhtive dhe hileve të shumta që janë munduar të fusin në Fenë e Allahut, gjë e cila ka shkakuar edhe zemërimin e Allahut kundër tyre. Zoti na ruajt nga këto cilësi, sepse ai që bën hile të shumta është i ngjashëm me çifutët, hilet e të cilëve janë të panumërta.

8. Hilet e ndaluara janë ato lloj hileshe, që shkaktojnë ndalimin e hallallit apo lejimin e haramit. Prej argumenteve që i ndalojnë këto hile janë:

- Hadithi i përcjellur nga Ebu Hurejra, se Resulullahi, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Mos bëni atë që bënë çifutët, me qëllim që t'i lejoni haramet e Allahut me hilet më të poshtra”. (Sahih – Mexhmual Fetava 29/29).

- Në suren Kalem, Allahu na rrëfen tregimin e atyre njerëzve, që kishin një kopsht shumë të mirë, me shumë fryte, por që Allahu atë kopsht ua asgjësoi krejtësisht dhe i la pa asnjë fryt. Shkaku për këtë ishte hilja e tyre, që kishin vendosur të shkonin herët në mëngjes në kopsht për t'i vjelë frytet e tij, me qëllim që të mos u japin asgjë të varfërve.

- Allahu po ashtu në Kuran na ka treguar për “**njerëzit e të shtunës**”, të cilët i shndërroi në majmunë, sepse sajuan një hile për të lejuar gjuetinë e peshkut në ditën e shtunë, gjë të cilën Allahu e kishte bërë haram për ata. E

këta, ç'bënë? Vendosnin rrjetat ditën e xhuma dhe peshqit që binin aty, i kapnin të dielën.

- Argument është edhe hadithi i temës tonë, i cili e demaskon çdo hile me të cilën njeriu dëshiron të shkelë një ndalesë. Ky hadith tregon se dispozita e një gjëje nuk ndryshon, nëse ia ndryshon formën. Aty na tregohet se çifutëve kur iu ndalua shitja e dhjavit të cofëtinës, ata e shkrinin dhjavin, e shitnin dhe pastaj hanin me ato të holla. Kjo është njësoj sikur t'i themi dikujt: Mos ha pasurinë e jetimit, dhe ai p.sh., ia shet shtëpinë jetimit, i merr të hollat, i ha për vete dhe thotë: Unë s'e kam ngrënë shtëpinë e jetimit!!!

Dobi:

Sheriati i ka parandaluar gjërat që çojnë në harame:

- Ka ndaluar t'i fyejmë zotat e mushrikëve (idhujtarëve, jobesimtarëve), sepse kjo do të jetë shkak që ata me zullumin dhe kufrin (mosbesimin) që kanë, do të fyejnë Allahun e Madhëruar.

- po ashtu i Dërguari, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të ka thënë: *"Prej gjynaheve më të mëdha është fyerja që njeriu ua bën prindërve. E pyetën: A ka mundësi të ketë aso njerëzish që fyejnë prindërit e tyre? Po, ia shan babën ndonjërit, dhe ai pastaj ia shan babën këtij, ose ia shan nënën ndonjërit, dhe ai pastaj ia shan nënën këtij".*

- Kjo shihet edhe nga fakti se Muhamedi, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, nuk i vrau mynafikët (dyfytirëshat), gjë e cila do të kishte shumë dobi për shoqërinë islame dhe për ruajtjen e rendit, me qëllim që të mos largohen njerëzit prej

tij dhe të thonë se Muhamedi po i vret shokët e vet.

- Grave ua ndaloi të parfumohen kur të dalin jashtë shtëpisë së tyre, sepse kjo mund të çojë në një haram të madh, zinanë.

- Ua ndaloi grave që t'ua përshkruajnë burrave të tyre gratë e huaja, që të mos u mbetet syri tek ato dhe të kenë pasoja të këqija, si shkurorëzimi etj.

- Ndaloj ndërtimin e xhamive mbi varre, madje i mallkoi ata që e bëjnë këtë gjë, me qëllim që të mos i adhurojë dikush dhe të mos mendojë se namazi në atë xhami është më i mirë dhe më i lëvdur.

- Ndaloj të falim namaz gjatë lindjes apo perëndimit të diellit, sepse në këto kohë qafirët i bien diellit në sexhde, ndërsa ne nuk duhet t'i ngjajmë atyre.

Edhe një dobi:

Ibën Kajimi thotë: "Shndërrimi në majmunë dhe derra padyshim se ndodh edhe tani me dy lloje njerëzish: dijetarë të këqij, të cilët shpifin ndaj Allahut dhe të Dërguarit dhe e ndërrojnë dinin dhe sheriatin e Allahut. Allahu do t'i ndërrojë fytyrat e tyre, sikurse ata e ndërruan Fenë e Tij; dhe të shfrenuarit në mëkate dhe të këqija, të cilat i bëjnë publikisht. Ata që nuk janë shndërruar në derra dhe majmunë në këtë dynja, ata do të shndërrohen në varr ose në Ditën e Kiametit".

(pjesë e shkëputur nga zinxhiri i mësimave për shpjegimin e librit "Umdetul Ahkam", që mbahen në dhomën "Islami në gjuhën shqipe" në Paltalk)

Dashuria ndaj Pejgamberit, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të

Bekir HALIMI

Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, në një hadith të cilin e shënon Buhariu dhe Muslimi na jep një mesazh dhe një mësim të rëndësishëm, ku thotë:

“Askush prej jush nuk beson derisa të jem më i dashur tek ai se prindërit, fëmijët dhe mbarë njerëzit”.

Ky hadith i vërtetë i Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, për vërtetësinë e të cilit nuk ka vend për komente, sepse e përcjellin Imam

Buhariu dhe Imam Muslimi, na shërben si një udhërrëfyes dhe kriter shumë i rëndësishëm për kuptimin e raportit tonë me Pejgamberin, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

Kohëve të fundit ballafaqohemi me lloj-lloj sjelljesh jo të ndershme ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, duke filluar nga injorimi i muslimanëve të figurës së tij e deri te vizatimi i karikaturave.

Shpeshherë muslimanët përpiqen ta



kompensojnë mungesën e raportit të ndershëm dhe të drejtë ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, me disa veprime që herë janë simbolike e herë janë pa bazë në sheriatin e Allahut.

Nga ky hadith mund të nxjerrim disa mësim dhe përfundime:

Dashuria ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, është dëshmi e besimit dhe është prej shtyllave të besimit.

Dashuria ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, është detyrim për çdo musliman, prandaj ai që e urren apo ka mëdyshje në dashurinë ndaj tij është jobesimtar. Allahu, subhanehu ve teal, thotë:

Dashuria ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, nuk është një pretendim i thatë dhe një shpresë e kotë, por pasim i Sunetit të tij, ndihmë e fesë së tij, veprim sipas Sheriatit të tij, dashuri ndaj shokëve të tij dhe largim nga ata që e shajnë dhe e armiqësojnë.

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të Dërguarit e Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të Allahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetët”. (El-Huxhurat: 15).

Dashuria ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, kërkon besimin e asaj që ai lajmëron, respektin në atë që ai urdhëron dhe largimin nga ajo që ai ndalon.

Dashuria ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, nuk është një pretendim i thatë dhe një shpresë e kotë, por pasim i Sunetit të tij, ndihmë e fesë së tij, veprim sipas Sheriatit të tij, dashuri ndaj shokëve të tij dhe largim nga ata që e shajnë dhe e armiqësojnë. Allahu, subhanehu ve teal, thotë:

“Thuaj: “Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë. Thuaj: “Binduni Allahut dhe të dërguarit, e nëse ata refuzojnë, atëherë Allahu nuk i do jobesimtarët”! (Ali Imran: 31- 32).

“Që pranojnë të dërguarin (Muhamedin), Pejgamberin arab (as nuk shkruan, as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), tek ata në Tëvrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe ua heq



atyre barrën e rëndë dhe prangat e vendosura mbi ta. Pra, ata që e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit. Thuaj (Muhamed): “O ju njerëz! Unë jam i Dërguari i Allahut te të gjithë ju. Allahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s’ka të adhuruar tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra, besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij, ndiqeni rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën”. (El-Araf: 157-158).

Disa njerëz pretendojnë se kanë dashuri ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, e kanë tepruar në këtë drejtim dhe kanë gabuar rrugën duke u larguar nga veprimet e sakta, kurse të tjerët që u treguan të mangët në dashurinë ndaj tij, u shkatërruan. Dashuria ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, realizohet duke i kryer veprimet tona në përputhje me Sheriatin e Allahut, me veprime të matura dhe mesatare, ku s’ka as apoteozë, as mangësi.

Allahu, subhanehu ve tealë, duke folur për gabimin që bënë të krishterët duke e rritur Isanë, birin e Merjemes, mbi pozitën e tij njerëzore, i kritikon ata dhe tregon devijimin e tyre të qartë në lidhje me këtë çështje dhe pa dyshim se me këtë kërkon nga muslimanët që mos të bëjnë këso gabimesh në raportet e tyre me Pejgamberin, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

“O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e

vërtetë. Mesihu, Isai, biri i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu), që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besojeni pra, Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: “Tre” (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë. Çfarë ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur. Mesihu nuk tërhiqet prej asaj se është rob i Allahut, nuk tërhiqen as engjëjt më të zgjedhur. Kush tërhiqet prej adhurimit ndaj Tij dhe bën mendjemadhësi, Ai do t’i ringjallë dhe do t’i tubojë të gjithë pranë Tij. E për sa u përket atyre që besuan dhe vepruan mirë, atyre do t’u përmbushet shpërblimi i merituar, por edhe do t’iu shtohet prej dhuntisë së Tij. Për sa i përket atyre që u tërhoqën dhe e mbajtën veten kryelartë, ata do t’i ndëshkojë me një ndëshkim fort të dhembshëm dhe pos Allahut nuk do t’i gjejnë vetes, as mbrojtës, as ndihmës”. (En-Nisa: 171-173).

Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, na thotë: “O njerëz! Ruajuni nga ekstremizmi në fe, sepse ata që kanë qenë para jush i ka shkatërruar ekstremizmi në fe”. (Sahih, Nesaiu).

Njerëzit që e kanë realizuar më së miri këtë dashuri janë shokët e Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, dhe ata që kanë ardhur menjëherë pas tyre, ata që kanë ndjekur rrugën e tyre. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, thotë: “Mos i shani shokët e mi. Pasha Atë në Dorë të Kujt është shpirti im po qe se dikush prej

jush shpërndan sa Uhudi flori, as nuk do të arrijë grushtin, as gjysmë grushti që kanë dhënë ata". (Sahih, Ebu Davudi).

Abdullah Ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: *"Mos i shani shokët e Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, sepse qëndrimi i dikujt prej tyre një orë (me Pejgamberin, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) është më i mirë se sa vepra e dikujt nga ju sa e gjithë jeta e vet"*. (Hasen, Ibën Maxhe).

Besimtari duhet t'i japë përparësi dashurisë së Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, para dashurisë së prindërve, fëmijëve dhe mbarë njerëzve. Prindërit dhe fëmijët janë njerëzit më të afërt të njeriut, prandaj kur e do Pejgamberin, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, më shumë se këta që i ka më të afërt, atëherë mos të flasim për të tjerët. Kjo domethënë se i duhet dhënë përparësi edhe respektit ndaj tij, para se të respektosh prindërit dhe fëmijët e tij, sepse nuk duhet respektuar krijesa në të bërit mëkat ndaj Allahut dhe Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: *"Thuaj (o i dërguar): "Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që fituat, tregtia që frikësoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se Allahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin e Tij. Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur"*. (Et-Teube: 24).

Abdullah b. Hishami thotë: Ishim me Pejgamberin, paqja dhe bekimi i Allahut

qofshin mbi të, që e kishte kapur për dore Omerin, Allahu qoftë i kënaqur me të, kurse Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, i tha: Resulullah! Të dua më shumë se çdo gjë, përpos vetes sime. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, i tha: Pasha Atë në Dorë të Kujt është shpirti im, nuk e ke besimin tamam derisa nuk më do më shumë edhe se vetja jote. Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: tani, ti je më i dashur tek unë edhe se vetvetja ime. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ia ktheu: Tani e plotësove besimin, o Omer". (Sahih).

Është normale të duam familjen, prindërit, fëmijët, farefisin përderisa nuk kundërshtohet Sheriati.

"Nuk gjen popull që e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) kanë skalitur besimin dhe e kanë forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerë në xhenet, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty janë përgjithmonë. Allahu ua ka pëlqyer punën atyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e Allahut, ta dini pra, se ithtarët e Allahut janë ata të shpëtuarit". (El-Muxhadele: 22).

Allahu na dhuroftë dashuri të sinqertë ndaj Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Amin.



S'po më kupton burri im!

Jahja ZEKERIIJA

Gruaja e mirë është thesari më i çmuar për një besimtar. Për raportet familjare duhet të kujdesemi dhe duhen mbrojtur, pasi prishja e tyre është pikësynimi i shejtanit fillimisht, por edhe i pasuesve dhe i ushtarëve të tij, xhind apo njerëz, që janë djaj po ashtu. Puna më “madhështore” për djallin dhe shoqërinë e tij është të jenë shkaktarë të ndarjes midis burrit dhe gruas së tij. Në hadithin që e shënon Muslimi në Sahihun e tij, i Dërguari, pagja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, thotë: “*Iblisi e vendos fronin e tij mbi ujë dhe pastaj i dërgon punëtorët e tij. Më i afërt me të është ai që ka bërë fitnen më të madhe, i afrohet njëri dhe i thotë: Kam bërë këtë e këtë. S’passe bërë gjë – ia kthen ai, ndërsa vjen tjetri dhe i thotë: Nuk u ndava nga një njeri derisa arrita ta ndaj nga gruaja e tij! Atë e merr pranë tij dhe i thotë: Sa i mirë që je!*”.

Problemet në raportet familjare vijnë

si rezultat i disa gjërave, por vetëm njëren prej tyre do të mundohemi ta ndriçojmë në këtë trajtim dhe ajo është: **moskuptimi nga bashkëshortët i natyrës së njëri-tjetrit.**

Prandaj sjellja e papërshtatshme midis bashkëshortëve për të zgjidhur problemet vjen si rezultat i natyrave të ndryshme të tyre, moskuptimit të kësaj ndryshueshmërie, rëndësisë së saj dhe shkallës së ndikimit, dhe mosrespektimi i kësaj ndryshueshmërie. Sa më shumë t’i kuptojmë këto dallime e ndryshime midis burrit e gruas dhe mënyrën e sjelljes, aq më tepër na bëhet e qartë mënyra e sjelljes me gjininë tjetër. Të kesh një pasqyrim të qartë për tjetrin dhe ta kuptosh atë, këto janë hapat e parë për të shëruar një problem midis tyre.

Ekzistojnë karakteristika ku bëjnë pjesë shumica e burrave, po ashtu edhe e grave. Secili prej tyre ka një botë të vetën dhe një kanun me të cilin sundon, prandaj kushdo që dëshiron të

Muhabetet, te shumica e burrave janë llafe jo të pëlqyera, prandaj shumica e tyre parapëlqejnë heshtjen, nuk bisedojnë për problemet e tyre, lodhjet madje as sukseset, sepse mendojnë që vetë dukja e rezultateve është argumenti më i madh për punën e tij.

bashkëpunojë me tjetrin, atij i duhet t'i nënshtrohet kanunit të asaj bote, ashtu që ta kuptojë dhe të vazhdojë rrugëtimin me hapa të qartë dhe të jetë i kujdesshëm për rreziqet dhe vështirësitë e asaj rruge.

Thuajse çdoherë burri logjikon në një mënyrë të ndryshme dhe bën veprime që korrespondojnë me logjikën e tij. Kështu është edhe me gruan, prandaj është e domosdoshme që secili prej tyre ta kuptojë tjetrin, në mënyrë që të arrijnë në pika të përbashkëta.

Burri sipas natyrës së tij anon prirja që të shfaqë fuqinë dhe aftësinë e tij për t'i zgjidhur problemet, ai ka një bindje të thellë se rezultatet janë të lidhura ngushtë me sukseset. Ai ngopet vetëm kur sheh suksesin, prandaj kujdeset shumë pak që të flasë me të shoqen për këto gjëra. Muhabetet, te shumica e burrave janë llafe jo të pëlqyera, prandaj shumica e tyre parapëlqejnë heshtjen, nuk bisedojnë për problemet e tyre, lodhjet madje as sukseset, sepse mendojnë që vetë dukja e rezultateve është argumenti më i madh për punën e tij. Prandaj mund të mos ketë ndonjë interesim që gruas së tij t'i shprehë dashurinë dhe t'i tregojë asaj, se ai është i gatshëm të sakrifikojë për familjen me gjithë çfarë ka, por këtë do ta tregojë vetë puna. Në vend të llaveve, që ndoshta i duken të thata dhe të pavlera, ai argumentohet me punë konkrete.

Punon për të përmirësuar gjendjen ekonomike dhe për t'i shtuar të mirat, duke e llogaritur këtë si argumentin më të mirë për të treguar sinqeritetin ndaj gruas dhe familjes. Ai kërkon që këtë gjë ta kuptojë edhe shoqja e tij dhe i ngushtohet qielli kur ka ndjesinë, se ajo nuk është mirënjohëse për mundin e tij. Madje paramendon se kushedi çfarë do të bëjë, ajo nuk do të kënaqet dhe nuk do të jetë mirënjohëse. Atëherë bën pyetjen: Çfarë mund të bëj më shumë se kaq?

Ndërkohë që gruaja sipas natyrës së saj është krejt emocione, kupton me të dëgjuar dhe me shqisa e ndjenja të buta. Ajo nuk i vlerëson punët sipas rezultateve siç bën burri, por i vlerëson sipas mundit të harxhuar në atë punë, prandaj ajo dëshiron çdoherë të dëgjojë sesa është lodhur, tregon kujdes për imtësitë, madje sa më shumë që lodhet për ndonjë punë, aq më shumë e arrin kënaqësinë, edhe nëse nuk janë realizuar rezultatet e pritura. Gruaja e çmon shumë sasinë e lodhjes, prandaj duhet t'ia shprehim atë.

Këtu pra, kemi një pikë të madhe dalluese mes burrit dhe gruas, e cila duhet të fshihet, detyrimisht ata duhet të gjejnë pikën e përbashkët, duke e kuptuar burri se e shoqja ka nevojë për njoftime të imtësishme, që pastaj të respektojë mundin e harxhuar të burrit dhe në anën tjetër gruaja duhet ta kuptojë se punët e mëdha që bën i shoqi nuk realizohen ndryshe veçse me mundime, lodhje dhe brenga të mëdha. Ajo po ashtu dëshiron që nga i shoqi të dëgjojë fjalë miradije dhe plot lëvdata për çdo të re që ndodh përreth saj. Ajo ka nevojë që i shoqi të ulet me të dhe të dëgjojë ankesat e saj dhe të tregojë interesim për to. Në ato çaste ndodh që ajo nuk i vëren sukseset dhe veprat e të

shoqit, sepse në çastet kur ajo ka nevojë për mbështetje dhe për ta dëgjuar, ajo nuk shihet asgjë edhe pse këtë nuk e bën me qëllim.

Pastaj mund të ndodhë që gruaja të përsërisë të njëjtat fjalë dhe të njëjtat ankesa, të cilat i shpreh përherë, gjë prej të cilës burri bezdiset duke i dëgjuar të njëjtat muhabete, ku njëherësh ajo nuk kërkon ndonjë zgjidhje konkrete, por kërkon nga i shoqi që edhe ai të emocionohet me te, të shfaqë edhe ai brengën për ankesat e saj, ta përkrahë atë dhe t'i ofrojë ndihmë.

Prandaj gruaja vlerëson çdo punë pozitive me të njëjtin vlerësim, te shumë gra blerja për të e një byzlyku prej diamanti është e barabartë me dhurimin e një karafili, apo me një buzëqeshje të ngrohtë. Ndërkohë që qëndrimi i burrit është krejt ndryshe, sepse ai i vlerëson gjërat sipas vlerës materiale që kanë dhe sasisë së mundit që është derdhur për t'i arritur ato.

Kështu që do të ishte mirë që burri t'i shtojë ca gjeste të vogla, por të bukura, që nuk kushtojnë ndonjë kohë a pasuri, dhe për të njëjtat gjëra të kërkojë nga e shoqja mirënjohje për punën dhe lodhjen që ai derdh për te dhe për shtëpinë, ku ai dëshiron të ndjejë krenari për ato suksese, meqë është munduar shumë...

Gabojnë ato gra që i bëjnë burrat e tyre të ndjehen se puna dhe lodhja e tyre është detyrim, dhe ata janë përgjegjësit e familjes, se në këtë rast burrat do ta ndjejnë veten të dështuar...

Ai nuk kërkon më shumë se një fjalë mirënjohjeje apo një shikim ngazëllues, i mjafton t'i thuash: Allahu të shpërbleftë me të mira. Dhurata më e mirë që një grua mund t'i bëjë burrit është vetëbesimi, të cilin ajo duhet t'ia përkrahë, vetëbesim në vendime dhe

vetëbesim në zgjedhjet e ndryshme. Nuk i prish punë debati që nuk e bën të ndjehet i lehtë, apo ta konsiderojë si fëmijën e tij, duke menduar se ai gjithmonë paska nevojë për këshillat dhe udhëzimet e saja.

Ndërsa dhurata më e pëlqyer që burri mund t'ia dhurojë të shoqes është përkrahja, ndihma, qëndrimi në anën e saj dhe dëgjimi i muhabetit të saj, sidomos në çastet kur ajo fillon të flasë për problemet që e shqetësojnë. Ki durim derisa të zbrazë qesen e saj, ndihmoje, përmbaje veten dhe harroje ç'ka thënë gjatë atij revolucionit dhe mos ia përmend më pastaj. Sepse pas këtij muhabeti dhe pas atij revolucionit ajo kthehet në natyrën e saj dhe ta njeh ty për respekt kujdesin, respektin dhe përkrahjen që pate për të, madje s'do ta harrojë asnjëherë dhe do të rikthehet e jotja siç ishte, bile edhe më e mirë.

Po ashtu duhet kuptuar edhe një pikë tjetër, që është pjesë e jetës së gruas, kjo duhet kuptuar mirë nga ana e burrit. Ka ditë të caktuara gjatë muajit, kur ndërron jeta normale e saj, gjendja shpirtërore i përkeqësohet, mërzitet shpejt, është gati për të qarë dhe shumë shpejt bie në provokime, nga cildo që e provokon sadopak, i cili duhet të durojë pastaj vrerin e mbledhur brenda saj. Kjo periudhë është pak para ciklit mujor dhe gjatë tij, por jo edhe pas tij, përveç në raste të rralla. Gjatë kësaj periudhe burri duhet të mos hyjë në konflikt me të dhe të mos i përgjigjet revolucionit me revolucion...

Nga kjo kuptojmë edhe diçka prej urtësisë pse shkurorëzimi në këtë periudhë nuk konsiderohet si i tillë, prandaj në gjuhën e sheriatit njihet "talak elbid'ij – shkurorëzim i shpikur"...

Nga arabishtja: Omer Berisha

Si të bëhesh nënë më e lumtur (2/2)

- 8 mënyra si të fokusoheni në gjëra pozitive -


Robert BARNETT

Kënaquni me momentin

Mënyrë për t'i shfaqur emocionet pozitive është kënaqja me momentin që e përjetoni. Veprimtaritë që zgjasin dy-tre minuta ndoshta do të kthehen në një kujtesë të këndshme, të cilat do t'i rikujtoni gjatë tërë jetës. Në mëngjes kur prej juve pritët të kryeni dhjetë punë, një pauzë për kafe e përcjellur me shikimin drejt fëmijës suaj, ndoshta nuk do ta ndryshojë jetën tuaj, por me siguri do t'ju qetësojë. Gilberti jep një ide tjetër: ndani brenda orës në të cilën jeni e angazhuar me ndonjë punë dhjetë sekonda për të vështruar atë që po bëni prej lartësie. Duke shikuar dhomën e ndejës, apo kuzhinën dhe fëmijën duke lozur, fytyrën e tij të bukur plot gjallëri, falënderojeni Zotin për mirësitë që ju ka dhënë. Është një metodë e mirë për t'i "kapur" gjërat pozitive në jetë dhe për zgjatjen e lumturisë.

Analizoni në mënyrë afatgjatë

Hareja do t'ju ndihmojë që më mirë t'i analizoni veprat që i kryeni. "Një qëndrim i tillë e shton durimin tuaj dhe ju mundëson t'i njihni vlerat e momentit, që do të kalojë shpejt." pohon M. J. Ryan, autorja e librit "Si të bëheni



të lumtur" dhe nëna e Anës nëntëvjeçare. Kur fëmija ime më sillte ndonjë problem thosha: Ajo këtë gjë nuk do ta bëjë për një kohë të gjatë dhe sot ndihem e lumtur për kohën që kalova me bijën time. Nëse ju krijon presion fakti se çdo ditë i ngjan tjetrës si veza vezës, paramendoni si do të dukej jeta pa fëmijë. Kur keni vendosur të bëheni prindër, juve keni vendosur për një punë që kërkon angazhim dhe që jo gjithmonë është e hareshme thotë Gilberti. Mund

Gruaja dhe familja

të ndodhë që pa hetuar të preokupoheni me imtësi, saqë ndonjëherë duheni të largoheni nga realiteti dhe të imagjinoni si do të dukej jeta pa këto persona që keni përreth.

Ripërtërimi lidhjen me bashkëshortin

Shokët dhe anëtarët e familjes janë shtyllat e një jete të lumtur. Në mesin e këtij rrethi shoqëror qëndron bashkëshorti. Rëndësi të madhe ka mirëmbajtja e komunikimit mes bashkëshortëve, veçanërisht në kohën më të tensionuar të martesës - kur fëmija është në moshën 1-3 vjeçare. Vonimi i angazhimit rreth martesës nuk është i tolerueshëm thotë Reivich. Qëndrim i shëndoshë dhe real është përkujdesja për gjërat t vogla, që nuk kërkojnë ndonjë angazhim të madh, por që forcojnë lidhjen tonë gjatë kësaj periudhe të vështirë. Bashkëshortët duhet të angazhohen së paku një herë në javë me njëri-tjetrin, në kohën kur fëmijët janë në gjumë. Nuk bëhet fjalë për takime me protokoll të caktuar, mjafton një ulje çlodhëse, bisede të lirë, ëndërrime të përbashkëta...

Mundohuni t'i zbuloni gjërat që mund t'i bëni bashkë, duke i shfrytëzuar interesat e përbashkëta. Burri kureshtar dhe gruaja që anon nga gjërat e bukura mund t'i kalojnë disa pasdite me vizita në muze. Një angazhim i mirë është kryerja e përbashkët e pazarllëkut, një darkë e rastit që automatikisht e ul tensionin.

Mënyrë tjetër për të forcuar lidhjen është praktikimi i "përgjigjes aktive dhe konstruktive". Për shembull, kur bashkëshorti kthehet në shtëpi dhe ndan me ty lajme të mira mos u mjaftoni me fjalët: Aha, mirë. Parashtroni pyetjen, si e

Nëse ju krijon presion fakti se çdo ditë i ngjan tjetrës si veza vezës, paramendoni si do të dukej jeta pa fëmijë.

ka kaluar ditën dhe pyetje tjera që dëshmojnë për interesimi tuaj. Bëhet fjalë për një angazhim që nuk zgjat më tepër se dy-tre minuta. Kështu gjatë atyre pak minutave, ju si çift do t'i festoni, gjërat e mira në jetën tuaj.

Thoni "faleminderit"

Shprehja e falënderimit është një prej mënyrave më të mira për të përmirësuar gatishmërinë. Falënderimin mundeni ta shprehni edhe me një lutje drejtuar Zotit, ose duke i shprehur mirënjohje ndonjë personi. Një mënyrë e mirë është që në një letër të shënoni veprat për të cilat mendoni se duhet të shprehni falënderimin tuaj; shënoni gjërat e mira që ju kanë ndodhur brenda ditës, juve, bashkëshortit, fëmijëve ose mikut. Gjërat për të cilat mundeni ti shprehni falënderimet tuaja munden të jenë të ndryshme, madje edhe një gjë e thjeshtë, si një fjalë ngazëlluese që e ka thënë fëmija gjatë ngrënies së mëngjesit. Ekspertët pohojnë se një vepër e tillë për çdo ditë brenda dy javëve do të rrisë dukshëm kënaqësinë tuaj.

Natyrisht se mundësia për një ditë të keqe, është evidente, edhe nëse iu përmbaheni këtyre këshillave. Zbatimi i këtyre këshillave do t'ju mësojë të mendoni pozitivisht dhe të kuptoni, se ju e kontrolloni lumturinë tuaj. Më parë mendoja se lumturia është një ndjenjë që ndërpritet, por ndjenjat vijnë pas mendimeve dhe nuk vijnë më parë, thotë Ryan. Duke vazhduar më tej ajo thotë: Lumturinë e shoh në tre gjëra-gëzim, kënaqësi dhe vetpërmbushje. Të qenit nënë këtë na e mundëson në çdo kohë, ndoshta e gjitha përnjëherë.

Nga anglistja: Talha Kurtishi

SI E DASHUROVA MBULESËN

Yvonne RIDLEY

Politikanët dhe gazetarët shkruajnë me kënaqësi për shtypjen e gruas në Islam... pa biseduar fare me femrat e mbuluara. Ata thjeshtë nuk e kanë idenë për respektin dhe mbrojtjen që e gëzon gruaja brenda kornizës islame të ndërtuar që para më tepër se 1400 vjet...

Megjithatë ata duke shkruar për çështje kulturore, si martesat e minorëve, synetimin e grave, vrasjet e nderit dhe martesat me detyrim, gabimisht besojnë se shkrimet e tyre janë fryt i qasjes shkencore. Jam e lodhur nga përmendja e Arabisë Saudite, si shembulli i vendit në të cilin gratë janë të shtypura, sepse ndalohen nga drejtimi i makinave.

Çështjet e lartpërmendura janë të natyrës kulturore dhe gabimisht i vishen Islamit. Rreth tyre shkruhet dhe flitet me qasje arrogante, në një atmosferë akuzuese ndaj Islamit. Prej meje u kërkua

të shkruaj se si Islami i lejon burrit të rrahë gruan e tij. Më falni, por ai pohim nuk është i saktë. Jam e vetëdijshme se kritikët e Islamit do të mundohen të më rikujtojnë për ajete nga Kurani dhe hadithe nga tradita profetike, që shpeshherë nxirren nga konteksti, por të flasim për një çast për disa statistika interesante. Sipas telefonit të hapur të shoqatës për dhunë shtëpiake, 4 milionë gra amerikane përjetojnë sulme serioze prej partnerëve të tyre brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore.

Mesatarisht çdo ditë ndërrojnë jetë më tepër se tre gra, si pasojë e sulmeve nga bashkëshortët ose partnerët e tyre... afro 5500 gra të vrara që nga njëmbëdhjetë shtatori. Ndoshta për disa, këto fakte janë aktpadi tronditëse për një shoqëri aq të civilizuar, por para se

Gratë në Perëndim shpeshherë trajtohen si mall, në një shoqëri në të cilën robëria seksuale është në rritje e maskuar nën eufemizmat e marketingut. Trupi i gruas tregtohet nëpër botë me anë të reklamave.

Gruaja dhe familja

të më akuzoni me ndjenja kënaqësie, më lejoni të theksoj se çështja e dhunës ndaj gruas është çështje globale. Është realitet fakti se një në tre gra përreth globit ka përjetuar rrahje, janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale pa dëshirën e tyre, ose janë abuzuar ndryshe gjatë jetës së tyre. Dhuna ndaj gruas i tejkalon kufijtë e religjionit, pasurisë, klasës, racës dhe kulturës. Para se të paraqitej Islami në skenën botërore gratë trajtoheshin si krijesa inferiore. Faktikisht ne akoma kemi probleme në Perëndim, ku burrat edhe sot mendojnë se janë superiorë ndaj grave. Ky fakt shihet qartë në gradimin e pozitave dhe në ndarjet strukturore të vendeve të punës, prej pastrueses deri të gratë me karrierë që futen në zyrat e drejtuesve. Gratë në Perëndim shpeshherë trajtohen si mall, në një shoqëri në të cilën robëria seksuale është në rritje e maskuar nën eufemizmat e marketingut. Trupi i gruas tregtohet nëpër botë me anë të reklamave. Siç e përmendëm më sipër, bëhet fjalë për shoqëri në të cilën dhunimi, sulmet seksuale dhe abuzimi i gruas janë sende të rëndomta, shoqëri në të cilat barazia gjinore është një iluzion, shoqëri në të cilat fuqia dhe ndikimi i gruas lidhen me madhësinë e gjoksit të saj.

Për gratë me mbulesë mendoja si për krijesa të qeta dhe të shtypura. Sot arrita t'i perceptoj si persona me shumë aftësi, talente, individë me aftësi ripërtëritëse, të lidhur mes vete aq fortë saqë lidhshmëria e tyre zbeh deri në parëndësi feminizmin bashkëkohor. Pikëpamjet e mia ndryshuan pas përvojës time tmerruese të arrestimit nga Talebanët, për shkak të hyrjes pa leje në Afganistan e maskuar me *burkë*, në

shtatorin e vitit 2001. Gjatë burgimit që zgjati dhjetë ditë bëra një marrëveshje me Talebanët, që të lexoj Kuranin dhe të studioj Islamin kur të lirohem. Përkundër tekave të ndryshme marrëveshja ime u zbatua dhe unë isha e lirë. E mbajta fjalën e dhënë, por si gazetarë që mbuloja rajonin e Lindjes së Mesme e kuptova edhe nevojën për të zgjeruar njohuritë e mia mbi Islamin, fe e cila qartësisht dukej se ishte mënyrë jetese.

Dhe jo, nuk jam viktimë e sindromës së Stokholmit. Që të jesh një viktimë e tillë duhet të lidhesh me rrëmbyesit e tu. Gjatë burgimit tim unë zihesha, i fyeja, i mallkoja dhe i abuzoja gardianët e mi, duke e refuzuar ushqimin e tyre në një grevë urie. Nuk e di kush u gëzua më tepër për lirin tim, unë apo ata.

Mendoja se leximi i Kuranit do të jetë një ushtrim i thjeshtë akademik. U trondita kur kuptova se Kurani e përcaktonte qartë gruan si të barabartë në natyrën e saj shpirtërore, në edukim dhe në pasuri. Lindja e fëmijës dhe kujdesi për të, pranohej si kualitet dhe veçori. Myslimanet e thonë me krenari, se janë ndërtuese shtëpie dhe amvisa.

Gjithashtu i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, thotë se personi më i rëndësishëm në shtëpi është Nëna, Nëna, Nëna. Ai gjithashtu ka thënë, se xheneti është nën këmbët e nënës. Cila grua, në "botën e qytetëruar" është renditur në top-njëqind-shin e njerëzve të jashtëzakonshëm, vetëm për shkak se ishte një nënë e mrekullueshme. Zgjedhja e gruas myslimane të mbetet në shtëpi dhe të kujdeset për fëmijët e saj ishte vendimtar që unë ta konsideroj atë si person dinjitoz, që meriton respekt. Ajo për mua është e barabartë

me ato motra që zgjedhin rrugën e karrierës dhe profesioneve të ndryshme.

Pastaj vazhdova duke lexuar për trashëgiminë, tatimet, pronën dhe ligjin e shkurorezimit. A nuk është qesharake kur ndonjë tabloid “në gjendje ekstaze” shpalos detajet e marrëveshjeve paramartesore, që nënshkruajnë disa yje të muzikës dhe filmit. Gratë myslimane kanë marrëveshje që prej ditës së parë. Ato zgjedhin çfarë do të bëjnë me pasurinë e tyre, ndërkohë që burri është ai që detyrohet me mirëmbajtjen financiare të shtëpisë dhe të familjes. Gjitha ëndrrat e lëvizjes feministe të viteve shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, për gruan myslimane janë realizuar që para 1400 vitesh.

Siç thashë, Islami e madhëron dhe e respekton gruan, si nënë e bashkëshorte. Është një nder shumë i madh të ndërtosh shtëpi dhe të bëhesh edukatori i parë i fëmijëve të tu.

Në mënyrë tepër të gabuar, deri diku irrituese trajtohet çështja e kodit të veshjes, që praktikohet nga gratë myslimane. Po, myslimaneja është e detyruar të vishet me rroba që shfaqin modestinë e saj, por ekzistojnë edhe çështje të tjera të rëndësishme, që prekin myslimanen e sotme dhe rreth të cilave vlen të flitet. Megjithatë shumica merret me hixhabin sikur e kanë fiks. Shiko, hixhabi është pjesë e uniformës time, e cila tregon se ke të bësh me myslimane dhe që pret të trajtohet me respekt. A mundet të marrësh me mend që dikush të kërkojë nga ndonjë drejtor i Wall Street-it, ose bankier i Uashingtonit të vishet me bluzë dhe xhinse?! Ai do t’ju tregojë se uniforma e tij e përcakton gjatë punës, duke

shprehur dhe dozën e duhur të seriozitetit.

Tashmë edhe në Britaninë e Madhe, ish-sekretari për çështjet e jashtme, Xhek Strou, perçen e ka shpallur si barrierë, e cila nuk është e mirëseardhur. Kur, o kur do të mësojnë burrat, se kur është në pyetje gardëroba e gruas ata duhet të heshtin?

Edhe ministra të tjerë, si Gordon Braun (tashmë kryeministër) dhe Xhon Reid, që vijnë nga Skocia ku burrat mbajnë funde (!!!), shprehën vërejtje rreth perçes.

Ngacmimet e ndryshme i vazhduan edhe disa deputetë, që e përshkruanin perçen si barrierë penguese për komunikim. Sa shumë gjepura. Nëse puna qëndron kështu atëherë kërkoj sqarim pse celularët, rrjeti nëntokësor, posta elektronike, mesazhet tekstuale dhe fakset akoma kanë përdorim ditor? Kush e dëgjon radion? Pse askush nuk e ç’kyç wireless-in e tij, kur nuk e sheh fytyrën e prezantuesit?

Shumica e motrave që unë i njoh të kenë zgjedhur perçen janë të racës së bardhë, të konvertuar me origjinë perëndimore, që nuk kanë nevojë për kujdes jo të mirëseardhur. Ata i dinë mirë shikimet nepsqare të atyre që kur takohen me femrat orvaten t’i ngatërrojnë në sjellje jo të hijshme.

Kam frikë se Islamofobia është strehimi i fundit për faqezinjtë racistë. Sulmet tinëzare shoviniste, në shumicën e rasteve të nisura nga burrat, janë të papranueshme për myslimanet dhe për motrat e tyre shekullariste majtiste. Kam qenë feministe për një kohë të gjatë dhe sot akoma jam feministe myslimane, që vepron për avancimin e çështjes së femrës. Dallimi i vetëm është që

feministet myslimane janë më radikale, se sa homologet e tyre shekullariste. Ne i urrejmë të gjitha ato kortezhe bukurie, ku aktrohet gëzim tej mase, kur paraqitja e mis Afganistanit me bikini, glorifikohet si një hap gjigant drejt çlirimit të gruas në Afganistan.

Në Afganistan u ktheva edhe disa herë të tjera dhe një gjë mund t'ua them të sigurt: nuk pashë gra karriere të ngritën nga rrënojat e Kabulit. Motrat e mia të Afganistanit pyesin: Kur do të ndalet Perëndimi nga obsesioni i quajtur *burkë*. Mos u mundoni që prej meje të krijoni një grua karriere, por punësoni burrin tim, më tregoni se si ta dërgoj fëmijën time në shkollë pa frikën se do të rrëmbehet prej dikujt. Dua siguri dhe bukë në sofrën time, këto ishin fjalët e një gruaje.

Myslimanet me prirje feministe, hixhabin dhe perçen i konsiderojnë si simbole politike, por edhe si detyrime fetare. Sipas disave ato botërisht janë një formë shprehjeje të refuzimit të mënyrës perëndimore të jetesë-konsumimit e alkoolit, seksin e rastit, përdorimit e drogave të ndryshme...

Epërsia në Islam arrihet me devocion, jo me bukuri, pasuri, fuqi, pozitë dhe gjini.

Tani më tregoni ç'ju bën të ndiheni më të lira? Të vlerësoheni në bazë të gjatësisë së fundit, apo në bazë të madhësisë së gjoksit të zmadhuar artificialisht? A mendoni se jeni më të lira, kur vlerësoheni në bazë të karakterit, mendjes dhe inteligjencës?

Tani më tregoni ç'ju bën të ndiheni më të lira? Të vlerësoheni në bazë të gjatësisë së fundit, apo në bazë të madhësisë së gjoksit të zmadhuar artificialisht? A mendoni se jeni më të lira, kur vlerësoheni në bazë të karakterit, mendjes dhe inteligjencës?

Revistat që në mënyrë agresive reklamohen tek ne, bartin mesazhin se femrat që nuk janë të gjata, të dobëta dhe të bukura, nuk janë të dashuruara dhe të dëshiruara. Revistat për adoleshentë bëjnë presion, që çdokush të ketë dashnor/dashnore janë thuajse skajshmërisht të ulëta në këtë kërkesë. Islami më njofton për të drejtën dhe detyrën time të kërkoj dituri, edhe kur jam e

vetme, edhe kur jam e martuar. Askund në kornizën Islame gruaja nuk urdhërohet vetëm me larje, pastrim dhe gatim për burrin. Jo vetëm myslimanët kanë nevojë të rivlerësojnë gruan në shtëpinë e tyre. Lexojeni e këtë ekstrakt nga fjalimi i Pat Robertson-it (të mbajtur në vitin 1992), në të cilin ai shpalos pikëpamjet e tija për gruan, së cilës i është dhënë pushtet. Pastaj kërkoj që ju të vlerësoni kush është i qytetëruar e kush jo:

Feminizmi i inkurajon gratë t'i braktisin bashkëshortët e tyre, t'i mbysim fëmijët e tyre, të praktikojnë magji, të shkatërrojnë kapitalizmin dhe të bëhen lesbike.

Ja një shembull i amerikanit që jeton në erën paraislamike dhe që ka nevojë të modernizohet dhe të qytetërohet. Njerëz si ky kanë mbulesë para syve dhe detyra jonë është t'ia grisim atë mbulesë, që njerëzit ta shohin Islamin ashtu si është.

Përshtati: Talha Kurtishi

Shfrytëzoji pushimet

53

Pyetje:

I nderuari shejh, Allahu ju dhëntë gjithë të mirat: Tanimë pushimet verore kanë filluar dhe secili prej nesh dëshiron t'i shfrytëzojë ato vetëm ashtu siç do të jetë Allahu i kënaqur me të, prandaj kush është porosia juaj për këtë... Allahu ju bekoftë?

Përgjigja:

Porosia më e mirë që mund t'i jepet një myslimani është devocioni. Kush i druhet Allahut, Ai do ta mbrojë, do t'i japë sukses dhe do ta udhëzojë. Kur Allahu e do një rob, i jep bereqet në

kohën e tij dhe e begaton në jetën e tij. Muslimani ka frikë nga zgjatja e jetës, sepse jeta e gjatë nuk është e mirë kurdoherë dhe me përfundim të lëvdur. Prandaj është nga suneti që besimtari të kërkojë strehim tek Allahu nga sprovat e jetës së kësaj bote dhe të vdekjes. Shumë njerëz kishin shpresa të jetonin gjatë dhe të përjetonin kohën, që në to nuk pati ndonjë hair, sytë e tyre u përplotën dhe zemra e tyre u thye, kohë në të cilat panë sprovat dhe vështirësi që vetëm Allahu i di.



Pyetje përgjigje

1 qershor 2008
25 Rabi' uth - thani

albiSLAM

Pushimi erdhi dhe Allahu e di se çfarë lajmesh dhe ndodhi ka fshehur përcaktimi i Tij (kaderi). Sa mirësi dhe mëshirë do t'i kapë njerëzit e mirë! Sa bela dhe fatkeqësi do t'i godasin njerëzit e këqij! E lusim Allahun e Madh, Zotin e Arshit të Madh, që është më mëshiruesi ndër mëshiruesit, që me bujarinë e Tij ta bëjë atë shtesë të jetës, shtesë të mirësive dhe të na mbrojë gjatë saj nga çdo sprovë.

Gjëja më e mirë me të cilën kalon jeta, me të cilat kalon nata e dita është respekti ndaj Allahut, dashuria ndaj Tij dhe të nxitosh në vepra që e kënaqin Atë. Ky është qëllimi i ekzistencës së krijesave: ***“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as që dëshiroj të më ushqejnë ata!”*** (Dharijat 56, 57). Gjëja më e mirë për të cilën harxhohet jeta dhe gjëja më e dashur me të cilën kalohet nata e dita është kërkimi i dijes, sepse i Dërguari, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Kush merr rrugën për të kërkuar dijen, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në xhenet”*. Ti do të jesh një nxënës dije, përderisa ulesh në mexhliset e dijetarëve dhe mëson me nxënësit e dijes dhe të hairit. Ti do të jesh një nxënës dije, përderisa hap librin për të mësuar ndonjë gjë të mençur, për të lexuar ndonjë ajet, apo për të parë ndonjë koment të haditheve të Resulullahut, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të. Ti do të jesh një nxënës dije, përderisa kalon netët duke shfletuar librat dhe duke mësuar çfarë thonë Fjalët e Qarta të Allahut dhe futesh në mirësitë e mëshirës.

Gjëja më e mirë për të cilën mund të kalohen ditët e netët dhe të harxhohet jeta është nxënia e dijes. Kërkimi i dijes është mëshirë, vlerë dhe nder nga Allahu. Nëse Allahu e zgjedh ndonjërin për këtë mision, kjo do të thotë se e ka zgjedhur për të mirën e dynjasë dhe të ahiretit. I Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Më i miri nga ju është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve atë.”*, dhe po ashtu ka thënë: *“Atij që Allahu ia do të mirën i jep kuptim në fe”*. Kur të shohësh njeriun se i do dijetarët, dëshiron të rrijë me ulematë, kënaqet të paraqitet në ligjërime, gëzohet kur dëgjon ajete që e udhëzojnë tek e mira, apo e ndalojnë nga e keqja, dhe me dëshirë të flakët dëshiron të dijë çka e urdhëron Allahu, që ta veprojë atë, dhe e ndalon Allahu, që të largohet prej saj; të jesh i bindur se Allahu e do këtë njeri dhe ia do të mirën atij. Njeriu nuk ka ndonjë vlerë tek Allahu, përveçse me këtë Fe. Njerëzit më të ngritur tek Allahu, pas pejgambereve janë dijetarët veprues, imamët e udhëzuar – Allahu me nderin, bujarinë dhe rahmetin më befte mua dhe juve të atillë.

Po ashtu gjëja më e mirë ku mund të harxhohet jeta e njeriut është adhurimi ndaj Allahut, gjëja më e dashur dhe më e lëvdur është namazi i shumtë. Njeriu gjatë studimeve dhe punës mund të mos ketë mundësi ta adhurojë Allahun sa duhet dhe të bëjë adhurime të shumta dhe vullnetare. Shumë e qëlluar do të ishte, që pushimet të jenë një mjet për ta mësuar veten të falësh namaz nate, të agjërosh ditën dhe të lexosh Kuranin. Myslimani duhet të

shfrytëzojë kohën e tij të lirë para se të preokupohet. Nëse këtë kohë të lirë nuk mundet ta shfrytëzojë për ibadet ndaj Allahut, atëherë kur do ketë mundësinë ta kalojë jetën e tij me respekt ndaj Allahut? Kur do ta ketë mundësinë, që exhelin ta përfundojë me kënaqësinë e Allahut. Nxënësi i mirëfilltë i dijes dhe njeriu i mirë tregon kujdesin e tij, që këto pushime t'i kthejë në një shkollë të adhurimit të Allahut.

Njoh nxënës dije të atillë, që gjatë pushimeve nuk ia lejonin vetes të kalonin tre net pa e përfunduar leximin e Kuranit dhe ka prej tyre që nuk i lejojnë vetes, që gjatë pushimeve të kalojë e hëna, e enjtja, apo ditët e bardha pa i agjëruar. Sepse gjatë ditëve të shkollës mund të mos ketë mundësi t'i bëjë ato gjëra, për shkak të vështirësive dhe lodhjes. Kështu që gjatë këtyre sezoneve mirë është që njeriu ta mësojë veten me adhurim të madh dhe bamirësi, ashtu që kur të preokupohet me punë të tjera dhe nuk gjen dot kohë të lirë, ai tashmë do të jetë mësuar dhe dashamir i punëve të mira.

Allahu, kur ia hap gjoksin robit të vet për punë të hairit, e do atë, e afron dhe ia lehtëson praktikimin e ibadeteve, edhe kur është i preokupuar. Ai që kohën e lirë dhe pushimin e vet e shfrytëzon për respektin, dashurinë dhe kënaqësinë ndaj Allahut, atëherë edhe në kohën e zënë, edhe gjatë ditëve të punës Allahu ia bën zemrën të përqendruar, dhe ky mbetet i vendosur në ato adhurime, madje i vjen rëndë të mos vazhdojë me ato punë të mira.

Po ashtu gjëja më e dashur, ku mund të harxhohen netët dhe

ditët është bamirësia ndaj prindërve. Myslimani gjatë kohës së lirë duhet të kujdeset që të shkojë për vizitë te prindërit dhe të mundohet t'i bëjë të lumtur ata. *"O i Dërguari i Allahut, kam ardhur nga Jemeni që të të jap besën për hixhret dhe xhihad". "A e ke nënën gjallë?" – e pyeti i Dërguari, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të. "Po," – u përgjigj. "A e do xhenetin?" "Po," – u përgjigj ai. "Rri pranë saj, se aty e ke xhenetin".* Le të shkojë te prindërit, le të mundohet t'i gëzojë, t'ua kryejë punët atyre dhe këtë kohë ta shfrytëzojë që të jetë sa më afër prindërve. Nëse jetojnë në një qytet, atëherë le të kujdeset që çdo nevojë të prindërve të tij ta kryejë sa më shpejt, çdo gjë që mund t'i gëzojë ata, le ta bëjë atë menjëherë. Bamirësisë së prindërve jepu përparësi pas urdhrave dhe detyrave që ke ndaj Allahut dhe asgjëje tjetër mos i jep përparësi para bamirësisë së prindërve. Kujdesu të jesh afër tyre edhe nëse kjo të kushton humbjen e shokëve dhe të miqve, edhe nëse të humbin udhëtimet dhe vizitat e ndryshme. Kujdesu t'i kënaqësh babanë dhe nënën, se kjo është gjëja më e mirë për ty, për Fe, dynja dhe vdekje. Kushdo që tregohet bamirës ndaj prindërve, Allahu do t'i sjellë lumturi për këtë bamirësi.

Gjithashtu mënyra më e mirë për të shfrytëzuar pushimet është vizita e farefisit, mixhallarë, halla, dajallarë dhe teze. Vizitoji ata që jeta të të zgjatet, rizku të të shtohet dhe kënaqësinë e Zotit ta arrish. Është farefisi, të cilin po i mbajte lidhjet me të, edhe Allahu i mban lidhjet me ty dhe po i këpute lidhjet me të, edhe Allahu i këput lidhjet me ty. Sa

udhëtim i bukur dhe fisnik që është, kur del nga shtëpia me dëshirën që të mbash lidhjet farefisnore për hir të Allahut. I merr me vete fëmijët e tu për të shkuar tek halla ose teza, dhe ajo të gëzohet, dhe ndoshta ajo ka ndonjë nevojë për ty, kurse ti ia kryen, apo e ndihmon me pasuri derisa kështu, Allahu të të japë bereqet në jetën tënde dhe në pasurinë tënde.

Pushimin gjithashtu mund ta shfrytëzosh për të ndenjur me njerëz të mirë dhe të devotshëm.

"Doli njëri nga fshati i tij për të vizituar për hir të Allahut një mik të tijin. Allahu i dërgoi një melek, që iu paraqiti atij në udhë dhe e pyeti: Ku je duke shkuar? Në fshatin tjetër – u përgjigj ai. Ç'kërkon atje? Kam një mik për hir të Allahut – u përgjigj. Mos vallë ke ndonjë interes që shpreson se ai do ta kryejë për ty? Jo, jo, thjesht ai është një mik imi për hir të Allahut – u përgjigj njeriu. Atëherë meleku i tha: Mua më dërgoi Allahu që të të tregoj se për shkak të kësaj vizite, Ai t'iu ka falur mëkatet". Pra, mund ta shfrytëzosh më së miri këtë pushim, duke vizituar njerëzit e mirë dhe dijetarët, ndenjja me ta duke u kujdesur për respektimin e tyre dhe gjetja e kohës së përshtatshme për vizita etj., gjatë të cilave mund të përfitosh shumë për këtë Fe, duke i pyetur ata për gjërat që njeriu ka nevojë, me të cilat përmirëson Fenë, dynjanë dhe ahiretin. Allahu e çmon atë rob që del nga shtëpia për të vizituar një dijetar, nga dija dhe devotshmëria e të cilit do të përfitojë. Kjo është një hair i madh që njeriu e arrin për Fenë, dynjanë dhe ahiretin e

tij.

Po ashtu edhe udhëtimet për adhurime, siç është udhëtimi për umre, veçanërisht nëse merr me vete edhe fëmijët apo dikë tjetër prej familjes, vëllezërit, motrat etj.

Për këto pushime, po ashtu do ta kishim këshilluar vëllanë mysliman, që të jetë më liberal me djemtë dhe vajzat e tij dhe të mundohet t'i gëzojë brenda kufijve të hallallit. Islami është që në të gjendet hairi për njerëzimin, hairi në Fe, dynja dhe ahiret. Njerëzit gjatë këtyre pushimeve kanë nevojë të ndjejnë gëzim, prandaj kur njeriu është në shtëpinë e tij, me familjen dhe fëmijët e vet, le të kujdeset që të fusë gëzimin tek ata, të dalë dhe të vizitojë ato vende ku nuk ka fitne, ose të bëjë së bashku me ata ndonjë gjë që do t'u kthehet me të mira për Fenë, dynjanë dhe ahiretin.

O Allahu ynë, kërkojmë të na japësh jetë, që Ty do të bëjë të kënaqur me ne. Kërkojmë o Allahu ynë, që jeta jonë të jetë shtim i çdo mirësie, ndërsa vdekja rehati nga çdo e keqe. O Allahu ynë, na ndero me shëndet mëngjes e mbrëmje dhe na përfundo jetën tonë me vepra të mira. Na fal neve, baballarët dhe nënat tona.

*(Kësaj pyetje i është përgjigjur dijetari
Shejh Muhamed Muhtar Shenkiti,
ligjërues në Xhaminë e Profetit, paqja dhe
lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, në
Medinë.)*

Përktheu: Ali Shabani Tanusha

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

SEXHDEJA, LLOJET DHE RREGULLAT

Abdulahdim b. Bedevij elHALEFIJ

Përveç sexhdeve që bëjmë në namaz, ka edhe disa lloje të tjera sexhdesh për të cilat do të sqarojmë në vijim:

Sexhdei tilaveh (sexhdeja pas leximit)

Në Kuran ka 14 ajete ku bëhet sexhde pas leximit të tyre, e para është në fund të sures Araf, pastaj në suret në Rrad, Nuh, Isra, Mejrem, në fillim të sures Haxh, në Furkan, Nemël, Sexhde, Sad, Fussilet, Nexhm, Inshikak dhe Alak.

Vendimi i sheriatit për sexhden tilaveh

Kjo lloj sexhde nuk është farz, por është mustehab. Kjo sexhde mund të bëhet në namazet farz, nafile, por edhe jashtë namazeve, domethënë në çdo kohë. Gjatë lindjes së Diellit, në perëndim dhe kur është në zenit. Drejt Kiblës ose jo drejt saj, me abdes apo pa abdes. Argument se sexhdja tilaveh nuk është farz është hadithi: “Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, kur lexoi suren Nexhm, në ajetin e sexhdes bëri sexhde.” Kurse kur lexoi Zejd b. Habani para Resulullahut paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, nuk bëri sexhde, me qëllim që të tregojë se nuk është detyrim”. (Buhariu dhe Muslimi). Ashtu siç e përmend Ibën Haxheri në komentin e Buhariut.

Ibën Hazmi thotë: “Për sa i takon bërjes së kësaj sexhde pa abdes dhe jo në drejtim të Kiblës, në çfarëdo forme ngase nuk është namaz, Resulullahu, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi, të ka thënë: “*Namazi i natës dhe i ditës është dy rekate, dy rekate.*” (Ebu Davudi).

Nga ky hadith nënkuptojmë se çfarë nuk është 2 rekatë, nuk është namaz, përveç nëse kemi argument, siç është vitri, namazi i xhenazes, kurse nuk kemi argument se kjo sexhde është namaz.

Vlera e sexhde tilaveh

Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë se Resulullahu, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “*Kur ta lexojë i biri i Ademit ajetin e sexhdes e të bëjë sexhde, largohet shejtani prej tij duke qarë dhe duke thënë: “Është urdhëruar të bëjë sexhde dhe e ka bërë, e për këtë fiton xhenetin, kurse më urdhëroi mua të bëj sexhde e nuk e respektova, për këtë më takon xhehenemi.”*

Çfarë thuhet në sexhde tilaveh

Posa të bësh sexhden thua tre herë: “SUBHANE RABBIJEL AËLA”, dhe pas kësaj thua atë që Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, na e mëson:

“Resulullahu, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, kur bënte sexhde-tilave gjatë leximit të Kuranit natën thoshte: “SEXHEDEVEXHHI LIL-LEDHI HALEKAHU UE SHEKKA SEM-AHU UE BESAREHU BI HAVLIHI UE KUVETITHI”¹

Sexhde shukër (sexhdeja për falënderim)

Është e pëlqyer që kur të të ndodhi diçka e mirë, shpëton nga ndonjë e keqe, ose përgëzohesh me diçka që të gëzon, të bësh sexhde, si shenjë e pasimit të Resulullahut paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të. Ebu Bekrete Allahu qoftë i kënaqur me të thotë: “Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, kur i vinte ndonjë lajm që e gëzonte ose që gëzohej në të shkonte në sexhde në shenjë falënderimi ndaj Allahut.”

Vendimi i sheriatit për këtë sexhde është njësoj si ai i sexhde-tilave.

Sehui sexhde — sexhdeja në rast gabimi

Shumë argumente na tregojnë se Resulullahu, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, bënte gabime gjatë namazit dhe thoshte: “Unë jam njeri, harroj sikurse harroni edhe ju e kur të harroj diçka më përkujtoni.” (Sahih)

Dhe për këtë gjë përcaktoi për umetin e tij rregulla, nga të cilat ne mund të përmendim këto:

1 — Kur ngrihej nga rekati i 2-të, duke mos u ul në teshehudin e parë

Abdulla b. Behineh Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon: “Na fali Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, dy rekate prej një namazi, pastaj u ngrit e nuk u ul në teshehud, edhe njerëzit u ngritën pas tij. Kur e kreu namazin prapësi, të bëri sexhde. Pasi e kreu namazin

mori tekbir, bëri 2 sexhde, duke qenë ulur pastaj dha selam.” (Buhariu dhe Muslimi)

Mugire b. Shube thotë: “Resulullahu, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Kur ndokush prej jush ngrihet plotësisht, le të mos ulet, por le t’i bëjë dy sehui sexhde.” (Ebu Davudi, Ibën Maxhe — sahih).

2 — Nëse i fal 5 rekate

Abdullahi Allahu qoftë i kënaqur me të thotë: “Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të e fali Dreknë 5 rekate e thanë: “A u shtua namazi, a?” Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të tha: “Pse po pyesni kështu?” i thamë: “I fale 5 rekate”, dhe atëherë i bëri dy sexhde pasi kishte dhënë selam.”

3 — Nëse jep selam në 2 rekate, ose në 3 rekate (domethënë para se të kryhet namazi).

Ebu Hurejre Allahu qoftë i kënaqur me të thotë: “Resulullahu, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, dha selam pasi i kreu 2 rekate, atëherë Dhul Jedejni i tha: “A u shkurtua namazi o Resulullah, apo harrove?” Resulullahu tha: “A të vërtetën e thotë Dhul Jedejni?” Njerëzit thanë: “Po”. Atëherë Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të u ngrit, i fali edhe dy rekate, pastaj dha selam, pastaj i bëri dy sexhde, pastaj u ngrit.” (Muslimi)

4 — Kur nuk di sa ke falur

Na përcjell Ibrahim i Alkame, i cili thotë: “Abdullah ka thënë: “U fal Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të dhe shtoi diçka në namaz, e kur dha selam i thamë: “O Resulullah, a u ndërrua diçka në namaz?” Ai tha: “Çfarë ndodhi?”. I thamë që shtove diçka. Ai i mblodhi këmbët, u drejtua nga ne me fytyrën e tij dhe tha: “Po të ndryshonte diçka në namaz do t’ua lajmëroja,

por unë jam njeri, harroj sikurse harroni ju. Nëse dikush prej jush dyshon në namazin e tij, le të mundohet të zgjedhi të vërtetën mbi të, le të plotësojë namazin pas selamit dhe le t'i bëjë dy sehui sexhde plus një selam."

Zgjedhja e së vërtetës ndodh duke u përkujtuar se çfarë ka lexuar në namaz, i kujtohet se ka lexuar dy sure, e me këtë i bëhet e qartë se ka falur 2 rekatë e jo një, ose i kujtohet se ka bërë teshehudin e parë e me këtë i bëhet e qartë se ka falur dy rekatë e jo një, ose i kujtohet se ka falur tre ose dy, pastaj i kujtohet se ka lexuar Fatihanë dy herë, e kështu i bëhet e qartë se i ka falur 4 rekatë, e jo 3. E kështu me radhë. E kur përpiqet të zgjedhë atë që është me afër së vërtetës, me këtë largon dyshimin. S'ka dallim këtu a falesh si imam apo vetëm. (Ibën Tejmije).

Mirëpo nëse nuk i qartësohet atij, atëherë bazohet në të sigurtën, që është më e paktë, siç tregohet në hadith: *"Ebu Seid Hudriu Allahu qoftë i kënaqur me të thotë: "Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të ka thënë: "Nëse ndokush prej juve dyshon në namazin e tij e nuk e di sesa ka falur 3 apo 4 rekatë, le ta hedhi poshtë dyshimin e le të bazohet në atë që është e sigurtë, e pastaj le t'i bëjë dy sexhde para se të japi selam, nëse fal 5 rekatë namazi i tij çiftëzohet me sehvi sexhde, e nëse i ka falur 4 është kundërshtim i dëshirës së shejtanit."*

Vendimi i sheriatit për sehui sexhden

Mendimi më i vërtetë është thënia, e cila bën dallim ndërmjet shtimit dhe mangësimit në namaz, ndërmjet dyshimit në zgjedhjen e së vërtetës dhe dyshimit, me të bazuar në të sigurtën për shkak se në këtë mënyrë veprojnë në të gjitha tekstet e nga ana tjetër është dallim

i logjikshëm.

Por nëse në namaz bëhet mangësim, p.sh., lënia e teshehudit të parë, atëherë duhet të plotësohet namazi, e plotësimi i namazit bëhet para selamit, ngase me dhënien e selamit vetëm se kemi dalë nga namazi. Por nëse ndodh në namaz shtesë, p.sh., ndonjë rekat më shumë, atëherë nuk është e udhës që në namaz të bëhen dy shtime, por bëhet sexhde pas selamit, pasi kjo gjë është kundërshtim i dëshirës së shejtanit, ngase kjo ka pozitën e një namazi të pavarur me të cilat sehui-sexhdeja e plotëson atë mangësi, edhe pse Resulullahu paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të i ka konsideruar dy sexhdet një rekatë.

Gjithashtu nëse dyshon e zgjedh të vërtetën, ai e ka plotësuar namazin e dy sexhdet janë për ta kundërshtuar dëshirën e shejtanit, e këto bëhen pas selamit. E nëse jep selam para se të kryhet namazi, pastaj i plotëson, atëherë selami (i parë) është shtim, e të bërit sexhde duhet të bëhet pas selamit, në shenjë kundërshtimi të shejtanit, mirëpo nëse dyshon e nuk i qartësohet e vërteta, në këtë rast ose i ka falur 4 ose 5, e nëse i ka falur dy sexhdet ia çiftëzojnë namazin domethënë konsiderohet sikur t'i kishte falur 6 rekatë, për këtë sexhdja duhet para selamit. Ky mendim që ne po përkrahim, është një mendim i cili i përdor të gjitha hadithet, asnjë hadith nuk e le pa përdorur, plus duke përdorur kijasin e vërtetë për atë formë që s'kemi tekst, duke krahasuar formën që s'kemi tekst me formën që kemi tekst, duke i futur kështu në një shkallë, kështu thoshte Ibën Tejmie.

Zgjedhi: Agim BEKIRI

Bota e parë përmes dimensionit shpirtëror

Shkruan: Ajni SINANI

Në kohët e vështira të ditëve tona vala e materializmit vrapuar ka pushtuar shpirtat e dëshpëruar të njerëzve, sepse tek ata është zbehur dhe dobësuar besimi tek Zoti dhe shpresa në mëshirën e Allahut. Prandaj na duhet t'i kushtojmë kujdes, që kjo epidemi e rrezikshme e hedonizmit dhe e individualizmit të mos rrënojë veçanërisht në shtresat e rinisë sonë muslimane.

Mund të themi me gojën plot, se libri **'Fjalë frymëzuese'** i shkruar nga Mirsadi është një kontribut i vyer kundër kësaj epidemie të kohës sonë.

Autori shkruan: "Ata që shkatërrojnë janë të shumtë, ata që ndërtojnë janë të paktë. Prandaj Shqipëria sot pret që t'i dalin zot." Kush më mirë sesa rinia do ta bënte këtë gjë, mu për këtë kapitulli i dytë titullohet: PËR NJË RINI MË AKTIVE NË BARTJEN E ISLAMIT.

Njeriu sot po vërtitet në një vorbull të turbullt shpirtërore dhe ndjehet i huaj në një botë që e shpiku vetë. Jetojmë në një botë, e cila të bën që shpeshherë e vërteta të duket e rrejshme, kurse e rrejshmja të duket e vërtetë. Kjo botë është e çuditshme. Çudinë e shpreh autori edhe në kapitullin e parë të këtij libri, që titullohet: ÇUDI!

Besimtari ruan në vetvete shumë gjëra me vlera shpirtërore, dhe sipas tij ato po kërcënohen çdo ditë, dhe atyre po iu



kanoset zhdukja. Shoqëria sot është në siklet dhe është katandisur në këtë gjendje të mjeruar, duke qenë e privuar nga dimensionit shpirtëror. Bota materiale po i josh njerëzit të besojnë se realiteti shpirtëror është jo-ekzistent, apo i demoduar në krahasim me botën që supozohet si e vetmja botë 'reale' dhe së cilës po i kanoset rreziku nga shthurja morale. Për t'iu shmangur këtij degradimi, njerëzimi ka nevojë për një besim të vërtetë dhe të paluhatsëm:

Shumë njerëz në periudhën e vështirësisë, apo mirëqenies bien nga provimi, përveç atyre që i ruan Allahu. Për këta njerëz Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Është e çuditshme gjendja e besimtarit, çdo gjë dhe çdo gjendje e tij është e mirë, kjo s'i ndodh askujt tjetër përveç tij. Nëse është në mirëqenie, është mirënjohës dhe kjo është një gjë e mirë për të, por edhe nëse e godet ndonjë fatkeqësi duron edhe kjo është e mirë për të"* e ata janë pak.

Le të citojmë një pjesë nga libri:

"Kjo gjendje në të cilën ndodhesh ti sot është një gjendje kritike. Një gjendje e tillë e bën çdo njeri të mërzitët e të trishtohet; mirëpo për besimtarin nuk duhet të jetë kështu... Ai ka një vizion

tjetër, është i fuqishëm, është i gatshëm të përballojë çdo problem... sepse ai e di se çfarë do Allahu bëhet dhe çfarë s'do Ai, s'bëhet!

Vetëm lidhja me Allahun është garanci për të mos rënë nga provimi në të dyja situatat.

Njeriu lind në kohën kur i duhet ta gjejë vendin e vet dhe në vendin ku i duhet ta gjejë kohën e vet. Ka rëndësi shumë të madhe që njeriu të dijë të jetojë me kohën dhe të jetë në gjendje ta shfrytëzojë atë."

Le të citojmë një copë tjetër nga libri i autorit:

"Prandaj vëllezër muslimanë të përpqemi edhe ne që ta shfrytëzojmë kohën e mos ta lëmë të na iki kot, ngase 'koha është anije, që nuk e hedh kurrë spirancën'... Zoti na bëftë prej atyre që e shfrytëzojnë kohën në dobi të njerëzimit."

Për të pasur siguri dhe garanci për ruajtjen e identitetit të brezit të ardhshëm janë dy elemente të pandashme, që njëkohësisht janë edhe alternativat e shpëtimit tonë dhe të fëmijëve tonë. Ato janë: besimi (edukimi) dhe arsimimi (dituria).

Të besosh do të thotë të dish se rrena nuk është e vërtetë; se errësira nuk është dritë; se e keqja nuk është e mirë; se dhuna nuk është drejtësi; se marrëzia nuk është urtësi. Të besosh: do të thotë të dish se besimi është çështje publike, e mosbesimi çështje private. Të besosh, pra, është të kthjellohesh, të zgjohesh nga gjumi letargjik, të vetëdijesohesh dhe t'i shohësh gjërat me syrin e besimit, me syrin e shpirtit. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "*Njerëzit janë në gjumë, kur vdesin zgjohen*".¹ Ndërsa ajetet vijuese e përshkruajnë shumë qartë gjendjen e mësipërme: "***Nuk është i barabartë i verbëri me atë që sheh. As errësirat me dritën. As hija me vapën. As nuk janë njësoj të gjallët me të vdekurit...***" (Fatir:

19-22).

Bota e sotme i ka lënë mënjanë të gjitha vlerat e larta shpirtërore, madje shpeshherë edhe vetë vlerat morale i gjykon nga këndvështrimi material.

Besimtari mundohet që ta ruajë shpirtin dhe mendjen të pastër dhe të kontribuojë, me aq sa mundet ai, në ruajtjen e trashëgimisë së mrekullueshme shpirtërore dhe padysim namazi është një thesar me shumë vlerë, që luan një rol të pazëvendësueshëm në këtë drejtim, ashtu sikurse thotë Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, se *namazi është shtylla e fesë*. Po citojmë përsëri një fragment nga libri:

"Namazi është motor i fuqishëm që e vë njeriun në lëvizje pesë herë në ditë. Është fuqi nga e cila buron adhurimi, pastërtia, kultura, qytetërimi, edukata, morali etj. Është arma më e fuqishme kundër nxitimit në punë të këqija dhe kundër stresit.

Në namaz balli ynë puth dheun, e provon sexhden dhe ndjen kënaqësinë e shijes së përljes."

Ky është çasti kur njeriu është më afër Krijuesit të tij.

Jemi të bindur se të dobët i duhet fuqia, e jo mëshira e humanizmi. Kjo tregon se ripërtëritja jonë duhet të jetë me mendje e fuqi, me dije e shkencë e jo me lot e vaj. Xhihadi ynë nuk duhet të shkojë rrugëve të shkatërrimit të asaj ku kanë përfunduar të tjerët, por xhihadi ynë duhet të përshkojë rrugët e mësimi, se si ne këtu të bëjmë atë që kanë bërë të tjerët. Duke shprehur rëndësinë e studimit, autori i librit njërin prej kapitujve do të emërtojë: **Jam krenar që studioj në medrese, jam krenar që jam medresist.**

"Unë jam krenar që studioj në medrese! Vendi ku mësohet për fenë e Allahut dhe për dritën që ndriçon në netët e errëta, në netët pa hënë të kohës së sotme, prandaj

¹ Kjo thënie nuk ka bazë në hadithet e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, por disa dijetarë e njohin si thënie e Alijut, radijallahu anhu. (O.B)

jam krenar që jam musliman.”

Duke pasur parasysh vlerën e madhe që i jep islami dijes, autori shpreh: krenarinë sepse studion në një shkollë, e cila mban emrin e një njeriu të madh, si Haxhi Sheh Shamia. Autori kujton me mall dhe nostalgji rahmetliun prof. Faik Lulin.

MALL PËR PROFESOR FAIKUN

“Profesor, më ka marrë malli të të shoh tekta ecje korridorit të medresesë, tekta ngjitje shkallët, tekta shpjegoje..., me atë kostumin (zakonisht blu), me kravatë, me flokë të thinjura, e me zemër të madhe, kështu të mbaj mend.”

Kështu e mbajmë mend të gjithë ne rahmetliun prof. Faikun. Ky është respekti që duhet treguar ndaj mësuesit dhe dijetarit, sepse siç na thotë Muhamedi, salallahu alejhi ue selem: *‘Dijetarët janë trashëguesit e pejgamberëve...’*

Ajo që i duhet njeriut bashkëkohor midis këtij moçali të turbulluar të botës mendore dhe fizike është porosia hyjnore. Islami na mëson se të gjitha krijesat, madje i gjithë universi është manifestim i fuqisë së Zotit. Njeriu është mëkëmbës i Zotit në tokë, prandaj për ta realizuar këtë mision kaq fisnik e kaq të shenjtë, ai duhet të jetë shërbëtor besnik i Krijuesit dhe të punojë që të zbatojë çdo urdhër të Tij. Vetëm kështu njeriu mund të ketë dinjitet të plotë, respekt dhe të arrijë lumturinë në këtë botë dhe shpëtimin në botën tjetër.

Vëllezër!

Mund të duket si paradoks, por shumë njerëz janë të vdekur megjithëse ata jetojnë. Ata nuk e dinë se çfarë kuptimi ka jeta dhe ata nuk bëjnë asgjë për veten e tyre, as për të tjerët. S’ka dyshim, ne nuk jemi dhe kurrë nuk duam të jemi nga këta njerëz. Vdekja nuk është tragjedia finale e jetës, ngase njeriu është një qenie e përjetshme, që nuk asgjësohet me vdekjen e tij. Ai është një qenie që vdes një herë dhe jeton dy jetë, jetën e sosur të kësaj bote dhe jetën e pasosur, të amshueshme

të botës tjetër.

Besimi nuk mund të imponohet me forcë, për arsye se ai është i natyrshëm. Mosbesimi imponohet me dhunë, ashtu siç bëri komunizmi, sepse është jo i natyrshëm.

Mjedisi i sotëm, që u lind nga mendja shekullariste, si rezultat i teknologjisë dhe shpikjeve të shumta ka çuar drejt largimit nga shpirtërorja, duke sajuar një mjedis materialist, që nuk është i përshtatshëm për masën dhe formën tonë. Njeriu i sotëm është përgjegjës, sepse nuk bën dallimin mes të lejuarës dhe të palejuarës. Ai nuk respekton urdhrat e Zotit.

Prandaj edhe shoqëria e sotme është një shoqëri që po bie moralisht dhe mendërisht dhe që vuan nga stresi e shqetësimet e shumta. Kjo gjithësi nuk duhet të reduktohet vetëm në rrafshin hapësinor-kohor pa horizont shpirtëror. Natyra është dhunti e falur nga Zoti në shërbim të njeriut. Nivelet e realitetit më të lartë shpirtëror nuk hyjnë në kategorinë e doktrave dhe përrallave!

Islami i hedh poshtë gjithë ato bindje dhe filozofira, të cilat njeriun e shohin nga aspekti dy-dimensional, duke e privuar nga dimensionin transcendent-shpirtëror.

Sikur i verbëri të ndërtonte një filozofi të mbështetur në përvojën e tij të botës, që del nga katër shqisat e tjera të tij, sigurisht ajo filozofi do të dallonte nga realiteti që do të perceptohej, duke u bazuar në ato katër shqisa dhe në shqisën e të parit.

Ajo që i mungon njeriut bashkëkohor është pikërisht vizioni shpirtëror dhe të parit e gjërave me syrin e zemrës: **“Pra nuk janë sytë të verbër, por zemrat që i kanë në kraharror.”** (el Haxh, 46)

Synimi i këtij libri është që të vejë në dispozicion një grup të dhënash fetare, që kanë të bëjnë me secilin prej nesh, e veçmas me rininë e kohës tonë, në mënyrë që të largojë shastisjen nga mendja dhe grimcimin e shpirttrave.